

AS

osce
Mission in Kosovo

A s s e m b l y I n i t i a t i v e

Newsletter

Maj 2003, No 06

- *Intervista me kryetarët e Komisioneve për Buxhet, Arsim, dhe Punë dhe Mirëqenie Sociale*
- *Kryeministri i drejtohet Kuvendit*
- *Rritja e përkrahjes së aktiviteteve të Kuvendit*

Nga redaktori

Gjatë intervistimit të kryesuesve të tri komisioneve të Kuvendit, ishte lehtë të vëresh se porosia e tyre e përbashkët ishte: është evidente nevoja për ndryshime dhe përmirësim të situatës, ndryshime në çështjet e arsimit, çështjet sociale dhe ato ekonomike. Nëse dëshirojmë të përparojmë, atëherë duhet bërë ndryshime. Përpjekjet e sotshme për përmirësim të situatës do ta përcaktojnë të ardhmen e Kosovës.

Në këtë aspekt, është inkurajuese të vëresh se me çfarë entuziazmi po punojnë organizatat e fondacionet e ndryshme, si një ekip i përbashkët, me Kuvendin e Kosovës për t'i vënë në jetë këto ndryshime dhe përmirësime, në mënyrë që t'ia sigurojnë një jetë më të mirë popullit të Kosovës. Ky buletin përmban artikuj mbi aktivitetet kryesore dhe këshillat që u janë dhënë deputetëve, komisioneve dhe të gjitha kuadrove të Kuvendit të Kosovës.

Në takimet e komisioneve të Kuvendit në të cilat morra pjesë gjatë javëve që shkuan, u inkurajova me diskutimet cilësore që u zhvilluan për projektligjet që i ishin dorëzuar Qeverisë. Poashtu, gjatë muajve të fundit, është shtuar edhe intenziteti i debateve politike. Njëra nga detyrat kryesore të çdo parlamenti, krahas veprimtarisë së tij ligjvënëse, është debati demokratik mbi opinionet e ndryshme.

Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe të gjitha organizatat partnere të Iniciativës për Mbështetje Kuvendit të Kosovës (ASI), angazhohen për shtimin e kapacitetit të Kuvendit të Kosovës. Ky buletin jep më tepër hollësi lidhur me këtë. Reagimet tuaja janë më se të mirëpritura.

Franklin De Vrieze,
Koordinator i Iniciativës për Mbështetje Kuvendit të Kosovës



ASI
Newsletter

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.de-vrieze@omik.org

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Komisionet e Kuvendit dhe kryesuesit e tyre

Komisioni për Buxhet	Haki Shatri
Komisioni për të Drejtat dhe Interesin e Komuniteteve	Dragiša Krstovic
Komisioni për Financa dhe Ekonomi	Slobodan Bjelic
Komisioni për Tregti dhe Industri	Bajrush Xhemali
Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji	Hajredin Kuqi
Komisioni për Kulturë, Rini dhe Sport	Edi Shukriu
Komisioni për Shëndetsi	Nafye Gas
Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor	Naim Maloku
Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale	Stojanka Petkovic
Komisioni për Transport dhe Komunikime	Edita Tahiri
Komisioni për Shërbime Publike	Nekibe Kelmendi
Komisioni i Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural	Tomë Hajdaraj
Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtarë	Sabri Hamiti
Komisioni i Gatishmërisë Emergjente	Agim Krasniqi
Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kormizën Kushtetuese	Arsim Bajrami
Komisioni për Peticione dhe Kërkesa Publike	Nergjivane Dauti
Komisioni për Personat e Zhdukur	Flora Brovina
Komisioni për Barazi Gjinore	Melihate Tërmkollli
Komisioni për Media	Bogoljub Milošević

“DUHET TA NDRYSHOJMË POLITIKËN FISKALE NË KOSOVË”

Në fillim të këtij viti, është mbajtur një diskutim intenziv në tryezën e rrumbullakët mbi çështjet ekonomike me përfaqësuesit e komisioneve të Kuvendit, ministrat, UNMIK-un dhe me ekspertët tjerë ekonomikë (shih artikullin në këtë edicion). Z. Haki Shatri, kryesues i Komisionit për Buxhet, në një intervistë dhënë ASI-it analizoi ndikimin e gjendjes aktuale në punën e komisionit të tij.

David Kahrman

Cilat janë aktivitetet kryesore të komisionit për buxhet?

Komisioni për buxhet është njëri nga dy komisionet kryesore të Kuvendit. Rëndomë, para se të rishqyrtohet ndonjë ligj në Kuvend, duhet të konsultohet Komisioni për Buxhet. Komisioni ynë shqyrton çdo ligj apo amendament që propozohet në Kuvend. Për çdo amendament që dëshirojmë ta bëjmë, ne së pari ia prezantojmë atë Kuvendit dhe pastaj Kuvendi e merr në shqyrtim.

A punon komisioni juaj kryesisht me Bashkësinë Ndërkombëtare, apo në mënyrë të pavarur?

Ne punojmë me këshilltarët që punojnë për Kuvendin, me këshilltarët e USAID-it, me këshilltarët nga Zyra e Kryeministrit dhe me zyrtarët që punojnë në të gjitha zyrat e ministrave. Ne bashkëpunojmë me OJQ të ndryshme, shoqata të biznesit dhe me Odën Ekonomike të Kosovës. Njëherësh bashkëpunojmë dhe konsultohemi edhe me ekspertë të fushave të ndryshme. Në këtë aspekt, seminari i fundit, i organizuar nga Fondacioni Fried-



rich Nauman Stiftung dhe OSBE-ja ka qenë shumë i dobishëm, ngase i ka bashkuar të gjitha këta akterë në tryezë të rrumbullakët.

Cilat janë prioritetet e Komisionit për Buxhet për vitin 2003?

Jemi duke bërë një punë intenzive në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve në Kuvend. Procesi i bartjes së kompetencave do të ndikojë në shtimin dhe intensifikimin e aktiviteteve të Komisionit për Buxhet.

Çfarë është vendosur të bëhet me mjetet që kanë tepruar në buxhetin e vitit të kaluar?

Tani jemi duke diskutuar mbi bilancin pozitiv. Në bazë të të dhënave që i ka m-

unë, bilanci i pashfrytëzuar pozitiv nga viti 2001 deri më 2002 është rreth 290 milion euro. Për Kosovën, e cila posedon aq pak burime financiare, një menaxhim i tillë i dobët është i papranueshëm. Shtylla e katërt e UNMIK-ut ka sugjeruar që bilanci pozitiv nga viti i kaluar të vihet në dispozicion të KEK-ut. Njëkohësisht, gjatë tre vjetëve të fundit KEK-u asnjëherë nuk ka dhënë ndonjë llogari për fondet që janë investuar aty dhe as për kthimin e kapitalit të investuar në këtë ndërmarrje. Kur disa përfaqësues të njërit nga komisionet e Kuvendit shkuan t'i marrin këto të dhëna, atyre nuk iu dha kurrfarë raporti apo dokumenti që

posedon ndonjë të dhënë relevante. Në rrethana të kështilla, akreditimi i bilancit pozitiv KEK-ut do të ishte akt i papërgjegjshëm.

Shumica e të hyrave në buxhet vijnë nga TVSH-ja, akciza dhe dogana. Cilat janë mënyrat tjera, përmes së cilave qeveria do të provojë t'i shtojë të hyrat në buxhet?

Mendoj se duhet ta ndryshojmë paksa politikën fiskale, sepse politika e tanishme fiskale nuk ofron kushte të mira për zhvillimin e sektorit privat. Politika që zbatohet në Kosovë paraqet metodën më të lehtë për mbledhjen e tatimeve, por nuk merrë parasysh veprimet anësore, sidomos sa i takon industrisë private. Njëherësh do të duhej të mendonim për zgjerimin e bazës për mbledhjen e tatimeve. Ne po përpiqemi ta arrijmë këtë përmes ligjit mbi tatimin në pronë, që e kemi propozuar kohë më parë. Pastaj, ne do të duhej ta ulnim shkallën maksimale të taksimit në disa rajone.

A ekziston ndonjë plan për të vënë ndonjë tatim mbi të ardhurat e atyre që jetojnë

në shtetet e jashtme?

Para së gjithash, kemi probleme me vënjen e tatimeve ndaj banorëve të Kosovës që punojnë për organizatat ndërkombëtare në Kosovë. Sa u përket rjerëzve që punojnë në diasporë, ata u nënshtrohen ligjeve dhe tatimeve të vendeve ku punojnë. Do të ishte shumë më mirë që t'i investonin mjetet e tyre në krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese. Ne kemi zhvilluar një analizë dhe kemi konstatuar se diaspora kosovare mund të posedojë afro 5 deri 6 bilion dollarë kapital. Institucionet kosovare duhet të ndërmarrin masa për të krijuar një terren më të përshtatshëm për investimin e një kapitali të tillë. Për shembull, nëse një investitor dëshiron të importojë teknologji për prodhim, atij duhet t'i mundësohet që ta paguajë doganën dhe tatimet tjera mbi teknologjinë e importuar më vonë, vetëm pasi që ai ta ketë filluar prodhimin dhe të ketë punësuar njerëz. Poashtu, importuesit e lëndëve të para duhet të trajtohen dhe të taksohen

ndryshe nga importuesit e prodhimeve të gatshme.

Sa e dëmton kontrabanda buxhetin?

Nuk ekziston ndonjë mënyrë për të përcaktuar saktësisht dëmet e shkaktuara nga kontrabanda. Por, në bazë të asaj që mund të vërejmë si qytetarë të thjeshtë të Kosovës, nuk e kemi vështirë të konstatojmë se kontrabanda paraqet një problem serioz.

A do të marrë pjesë Komisioni për Buxhet në bisedimet e ardhshme me Beogradin?

Nuk jemi të njoftuar se duhet të jemi të përgatitur për bisedime të tilla, sidoqoftë, ekzistojnë shumë çështje mbi të cilat do të duhej të bisedonim me ta, si bie fjala taksimi dhe doganat.

Kur do të jetë Kosova e aftë që ta financojë vetëveten dhe njëkohësisht popullit t'ia sigurojë së paku minimumin e standardeve evropiane?

Mendoj se Kosova duhet të angazhohet për integrimin e vet në rajon dhe në Evropë. Nëse Kosova integrohet në këto struktura, standardi patjetër do të përmirësohet. Mbase diku pas pesë vjetëve, ne do ta shohim Kosovën në rrugën drejt prosperitetit ekonomik, pa probleme të mëdha sociale apo ekonomike.

ZHVILLIMET E FUNDIT NË KUVEND

Gjatë dy muajve të fundit Kuvendi është ballafaquar me shumë sfida. Në vijim kemi paraqitur një përmbledhje të aktiviteteve të periudhës (deri më 15 prill 2003) që u karakterizua me debate intenzive politike.

Franklin De Vrieze

Dy rezolutat dhe largimi i sërbëve

Në sesionin plenar të Kuvendit të 27 shkurtit "Koalicioni Kthimi" (KP) e braktisi seancën, pasi që shumica e anëtarëve të Kuvendit vendosën që të shtojnë edhe dy pika të jashtëzakonshme të rendit të ditës për këtë seancë. Në të vërtetë këto "çështje urgjente" ishin deklarata mbi arrestimin e Fatmir Limajt, kryesues i grupit parlamentar të PDK-së, nga ana e Tribunalit të Hagës dhe deklarata kundër krijimit të Unionit të komunave sërbe. Grupet parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe komuniteteve tjera përkrahën rezolutën, ndërkaq KP-ja deklaroi se këto çështje janë jashtë mandatit të Kuvendit. Rezoluta mbi paditë e ICTY-së ripërsëriti përkrahjen për Tribunalin e Hagës, por bëri thirrje për lirin e Z. Limaj, i cili do të gjykohet së shpejti.

Përplasjet në mes të PDK/AAK dhe LDK gjatë marsit të vitit 2003

Puna e Kuvendit gjatë marsit 2003 u shënuar me vazhdimin e përplasjes midis PDK/AAK-së dhe LDK-së. Z. Bujar Dugolli, kryesuesi i grupit parlamentar të AAK-së, i përkrahur nga grupi parlamentar i PDK-së, propozuan një rezolutë mbi "njohjen e vlerave të luftës të UÇK-së për çlirimin e Kosovës". Gjatë disa javëve, Presidencia e Kuvendit në seancat plenare debatoi një kohë të gjatë lidhur me atë se a duhet të futet kjo rezolutë e propozuar në rendin e ditës apo jo. Kështu, më 6 mars, kjo çështje shkaktoi edhe shtyerjen e seancës plenare për një javë. Prandaj, më 20 mars, anëtarët e PDK-së dhe AAK-së madje e bojkotuan seancën plenare, për arsye të mospërfshirjes së rezolutës mbi vlerat e luftës në rendin e ditës. Krahas kësaj, personalitetet kryesore të këtyre dy partive, bënë thirrje për rishqyrtimin e modelit të bashkë-

qeverisjes tri-partiake dhe marrëveshjes për koalicion që përbën bazën e qeverisjes së tanishme. Njëkohësisht, më 20 mars, Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci propozoi që debati mbi fjalimin e parë vjetor të Kryeministrit të shtyhet "për të mirën e ruajtjes së stabilitetit dhe unitetit të institucioneve kosovare". Edhe pse përçarja midis partive shqiptare në Kuvend u bë më se e dukshme, Kryeministri megjithatë shprehu besimin se Qeveria do të vazhdojë veprimtarinë e saj. Përkundër kësaj, seanca plenare e

Kuvendit më 27 mars u mbajt me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve parlamentare, pas përkrahjes që iu dha Kryeministrit dhe marrëveshjes për koalicion nga ana e përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare në Prishtinë. Duke mos përmendur rezolutat kontestuese, Z. Dugolli theksoi se koordinimi i mëtejshëm me grupet e tjera parlamentare, posaqërisht me LDK-në, është i nevojshëm në mënyrë që të harmonizohen qëndrimet para se të prezantohen çështjet përsëri në Kuvend.

Bujar Dugolli, kryesues i Grupit Parlamentar të AAK-së, më 6 mars 2003.



Vrasja e Gjingjiqit shkakton shtyerjen e bisedimeve në mes të Beogradit dhe Prishtinës

Vrasja e Kryeministrit Sërb Zoran Gjingjiq më 12 mars 2003 ka tronditur sërëbët e Kosovës. Anëtarë i presidencës së Kuvendit dhe anëtarë i Koalicionit Kthimi, prof. Gojko Saviq, tha: "Ka ardhur një periudhë e pasigurisë për sërëbët e Kosovës." Përderisa qeveria e Kosovës e dënoi vrasjen si "veprim qyqar", Kryetari i Kuvendit Prof. Daci tha se Gjingjiq ishte simbol i fillimit të procesit demokratik në Sërbi dhe shtoi se vrasja do të dëmtojë edhe procesin e demokratizimit të rajonit. KP-ja nuk morri pjesë në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 13 mars, në shenjë respekti ndaj periudhën zyrtare të mbajtjes së zisë në Sërbi.

Ngjarjet në Sërbi i kanë pezulluar përpjekjet për fillimin e bisedimeve direkte, siç qe propozuar nga PSSP-ja më 3 mars midis Prishtinës dhe Beogradit mbi "çështjet praktike", që do të ishin në interes të popullit të Kosovës. Propozimi për bisedime të drejtëpërdrejta vjen pas darkës zyrtare të 28 shkurtit, të cilën z. Shtajner e kishte shtruar për nder të Kryeministrit z.Rexhepi,

Kryetarit të Kuvendit z.Daci, Kryetarit të Kosovës dhe të LDK-së z.Rugovës dhe kryetarit të PDK-së z.Thaqit. Qëllimi i këtij takimi ishte që të kremtohet njëvjetori i formimit të koalicionit qeverisës dhe të shohiten hapat e mëtejme që duhet ndërmarrur në të ardhmen. Deklarata e përbashkët e lëshuar pas takimit të 28 shkurtit bëri thirrje për "dialog të drejtëpërdrejt me të gjitha vendet.... për të diskutuar lidhur me çështjet praktike me interes të përbashkët". Pas vrasjes së Kryeministrit Gjingjiq, z. Shtajner bëri me dije se tani do të nevojitet më shumë kohë për të mundur fillimin e bisedimeve.

Kodi i ri penal mbi krimin shqyrtohen nga Kuvendi

Më 28 mars PSSP Shtajneria paraqiti draftin e kodit të ri penal si dhe draftin e kodit të procedurës penale Kryeministrit, në mënyrë që Qeveria dhe Kuvendi të kenë mundësinë për t'i shqyrtuar dhe për t'i dhënë vërejtjet për këto dokumente. Përkundër faktit se në bazë të kompetencave të rezervuara të PSSP-së këto ligje do të aprohohen si Rregullore të UNMIK-ut, z. Shtajner vuri në dukje se: "Institucionet kosovare megjithatë,

duhet të jenë plotësisht të përfshira në këtë nismë kaq të rëndësishme ligjore".

Përgatitja e këtyre dy kodeve ishte një ndërmarrje shumë e rëndësishme, në të cilën morrën pjesë ekspertët ligjorë të Komisionit të Përbashkët Këshillues të Çështjeve Legjislative, e cila në të vërtetë kishte filluar me iniciativën e PSSP-së së atëhershëm z. Bernard Kushner. Ekspertët juridik nga Këshilli i Europës, OSBE-ja, Asociacioni Amerikan i Avokatëve- Iniciativa Ligjore për Europë Qendrore dhe Lindore (ABA-CEELI), UNICEF-i dhe agjensitë tjera kanë luajtur rol të rëndësishëm në hartimin e këtyre kodeve. Në këtë drejtim janë kryer konsulta intensive përbrenda komunitetit ligjor të Kosovës. Prandaj, gjykatësit, prokurorët, juristët dhe akademikët kanë patur rastin t'i rishikojnë dhe rishqyrtojnë këto tekste dhe t'i japin vërejtjet e tyre. Njëherësh, janë zhvilluar konsulta edhe përbrenda UNMIK-ut, përfshirë këtu edhe Shtyllën e I-rë dhe Zyrën Legale në selinë e KB-së.

Kuvendi debaton mbi

Sistemin e Drejtësisë

Drejtësisë dhe Kornizës Kushtetuese. Raporti para-

sheh reforma substanciale përfshirë edhe rritjen e numrit të gjykatësëve, prokurorëve dhe asistentëve profesional ligjor në gjyqe, krijimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës Kushtetuese, sikurse edhe respektimin e parimit të ndarjes së pushtetit gjyqësor, ekzekutiv dhe legjislativ.

Z. Arsim Bajrami, Kryesues i Komisionit të Kuvendit, tha se arsyet kryesore për situatën e vështirë të krijuar në sistemin e gjyqësisë janë politika e dobët kadrovike dhe "ligji i aplikueshëm", i cili daton qysh prej kohës së ish-Jugosllavisë dhe i cili është ende duke zbatuar vetëm e vetëm për të evituar vakumin ligjor.

Ndërkaq, z. Dragisha Kërsitoviq (KP) theksoi se kritikën e bëra në raportin e Komisionit të Kuvendit ndaj ligjit të ish-Jugosllavisë nuk ishin të drejta. Duke bërë fjalë mbi nevojën për një diskutim të frytshëm mbi reformimin e sistemit të Drejtësisë, ai ritheksoi se Kuvendi nuk duhet të diskutojë akuzat individuale ndaj disa sërëbëve, por se këto punë u duhet lënë gjyqeve.

Z. Kady në fjalën e tij vuri në pah se përkundër të gjitha këtyre është

vërejtur një përmirësim i dukshëm në sistemin ligjor të Kosovës, nëse kihet parasysh fakti se sistemi i gjyqësisë u desh të ndërtohej prej fillimit, 4 vite më parë. Ai tha se numri i gjykatësëve dhe i prokurorëve për banorë ka arritur mesataren Europiane. Në reagim e tij ndaj kritikave lidhur me ligjet e ish-Jugosllavisë të cilat ende aplikohen, ai theksoi se vetëm ligjet të cilat nuk përmbajnë dispozita diskriminuese janë në përdorim. "Ne nuk mund të sjellim pako të ligjeve të reja në çantat tona të punës" shtoi Z. Kady. Ai poashtu vuri në dukje se bërë një punë e mirë rreth kodit të procedurës penale dhe kodit penal, e cila do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës, duke shtuar se: 'Pastaj mund të thoni se i keni ligjet tuaja'. Z. Kady më tutje theksoi se, 'Multi-etniciteti në sistemin gjyqësor do të jetë praimi kryesor, sepse për momentin ka vetëm 5% gjykatës dhe vetëm 2% prokuror sërëb, përderisa minoritetet tjera janë të përfaqësuar në një përqindje më të madhe'. Ai përshëndeti përpjekjet dhe angazhimet e gjykatësëve dhe të prokurorëve për të qenë të paanshëm, pavarësisht nga kërcënimet dhe presionin që u bëhen.

Kuvendi aprovon raportin e Komisionit për persona të zhdukur

Më 10 prill Komisioni i Kuvendit për persona të zhdukur paraqiti raportin e tij në seancën plenare. Kryesuesi i komisionit, Flora Brovina tha se 4,000 persona ende konsiderohen të zhdukur. Ajo theksoi se kampet dhe burgjet private me njerëz nga Kosova ende ekzistojnë në Sërbë. Ndërsa, Stojanka Petković (KP) nga ana tjetër, shtroi çështjen e personave të zhdukur sërb dhe të komuniteteve tjera, të zhdukur gjatë dhe pas konfliktit. Brovina sqaroi se shifra prej 4,000 personave të zhdukur përfshinë edhe anëtarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, d.m.th edhe sërëbët. Kuvendi aprovoi raportin e Komisionit, ku është përfshirë edhe një rekomandim për përgatitjen e një draft rezolute mbi fatin e personave të zhdukur.

Kuvendi merr raportin e 10-të për vlerësimin e situatës së minoriteteve

Më 10 mars OSBE-ja dhe UNHCR-ja publikuan raportin e përbashkët mbi "Vlerësimin mbi gjendjen e minoriteteve etnike në Kosovë". Ky raport kishte për qëllim që të ofrojë vlerësimin objektiv të situatës së minoriteteve në mënyrë që t'u mundësojnë

institucioneve qeveritare kosovare të vendosin përmasat që duhet ndërmarrë jo vetëm për të mundësuar kthimin, por edhe për të përmirësuar kushtet e minoriteteve që tashmë ndodhen në Kosovë. Mirëpo, në këtë vlerësim konstatohet se, edhe përkundër përmirësimeve që u bënë gjatë gjysmës së vitit të kaluar, minoritetet ende kanë probleme me qasjen në shërbimet kryesore, si të drejtat pronësore, strukturat e sistemit të drejtësisë, publike, civile dhe politike si dhe sigurinë dhe lirinë e lëvizjes. Shqetësim i vazhdueshëm mbetet diskriminimi ndaj pakicave, sa i takon mundësitë për punësim në sektorin publik si dhe diskriminimi i tyre në qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve esenciale siç janë, shërbimi shëndetësor, arsimor dhe shërbimi social. Në raport më tutje propozohet që të miratohet ligji gjithëpërfshirës antidiskriminues nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të sigurojë mbrojtje më të fuqishme ndaj diskriminimit të grupeve të ndryshme në shoqëri, përfshirë edhe minoritetet etnike. Të gjithë anëtarët e Kuvendit morrën nga një kopje të këtij raporti. Raporti mund të lexohet edhe në këtë adresë në internet: http://www.osce.org/kosovo/documents/reports/minorities/min_rep_10_alb.pdf

Nxjerrja e ligjeve

Më 15 prill 2003, PSSP-ja z. Steiner ia ka dërguar një letër prof. Dacit, Kryetarit të Kuvendit, me të cilën e informoi atë lidhur me nxjerrjen e disa ligjeve siç janë Ligji për Mbrojtjen e Ambientit, Ligji për Likuidimin dhe Riorganizimin dhe Ligji mbi Farërat. Në letrën e tij PSSP-ja vuri në dukje se katër ligje të tjera, të cilat i janë dërguar atij dhe të cilat po presin të nxirren, janë në kundërshtim me Rezolutën 1244 të KSKB-së (1999) dhe Kornizën Kushtetuese (KK). Këtu përfshihet Ligji mbi Shkollimin e Lartë në Kosovë, Ligji mbi Tregtinë e Jashtëme, Ligji mbi Telekomunikacionin dhe Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Kontabilitetin. Ai kërkoi nga Kuvendi që këto ligje t'i harmonizojë me Rezolutën 1244 të KSKB-së (1999) dhe KK-së, deri më 30 prill 2003. PSSP-ja poashtu vuri në dukje se nëse Kuvendi nuk ndërmerr diçka lidhur me këtë, ai do t'i dekretojë këto ligje duke i përfshirë në to edhe ndryshimet e domosdoshme për t'i harmonizuar ato me Rezolutën 1244 (1999) të KSKB-së dhe KK-së. Menjëherë pas marrjes së kësaj letre, Qeveria shprehu gatishmërinë për të marrë pjesë në mekanizmat konsultativë lidhur me këto



Prof. Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit, mori një letër nga PSSP-ja Z. Steiner mbi nxjerrjen e ligjeve.

ligje. Krahas kësaj, Komisionet e Kuvendit janë takuar në mënyrë që t'i shqyrtojnë propozimet lidhur me ndryshimet e këtyre ligjeve. Procesi legjislativ gjatë punës në Kuvend është tendosur shumë gjatë viti të kaluar për shkak se shumica e ligjeve të cilat janë miratuar nga Kuvendi ende nuk janë dekretuar. Arsyet për mos nxjerrjen e këtyre ligjeve janë të ndryshme dhe komplekse. Zyrtarët e Kuvendit shpresojnë se ka mundësi që të gjindet zgjidhje për këtë çështje. Megjithatë, ndryshimet në Ligjin mbi Shkollimin e Lartë duket të jenë më të ndjeshmet.

Themelimi i Komisionit për Media

Më 3 prill 2003, në mbledhjen plenare të Kuvendit është miratuar përbërja e Komisionit të posa themeluar për Media. Komisioni përbëhet prej 11 anëtarëve, duke përfshirë përfaqësuesit e 5 grupeve parlamentare. Kryesuesi i Komisionit është z. Bogoljub Milosevic (Koalicioni Kthimi). Zëvendëskryetari i parë i Komisionit është z. Sabit Rustemi (LDK) dhe zëvendëskryetari i dytë i Komisionit është Z. Lirak Celaj (PDK).

LIGJET MBI BUJQËSINË PËR VITIN 2003

Përveç ligjeve ekonomike dhe shoqërore, Kuvendi ka filluar t'i miratojë edhe disa ligje mbi bujqësinë. Këto ligje kanë për qëllim të krijojnë një bazë ligjore për ringjalljen e domosdoshme të sektorit të bujqësisë në Kosovë. Në tekstin e mëposhtëm mund të lexoni një përmbledhje të shkurtër të këtyre ligjeve.

Guillaume Wagener, Këshilltar ndërkombëtar pranë Departamentit Ligjor dhe Procedural të Kuvendit të Kosovës

Ligji mbi farat

Ligji mbi farat, rregullimin e prodhimit dhe tregëtimit të farërave të kulturave të ndryshme bujqësore, përfshirë këtu hibridët, rasatet e ndryshme për lisa, pemët, perimet, vreshtat dhe patatet.

Ministria e Bujqësisë do të jetë përgjegjëse për shqyrtimin e fletëkërkesave mbi përfshirjen e llojeve të reja të farave në listën zyrtare, si dhe për dhënjen e të drejtave kultivuesit të bimeve. Për këtë arsye do të themelohet Zyra mbi të drejtat për llojin e bimëve, e cila do të jetë përgjegjëse për administrimin e të gjitha këtyre çështjeve.

Fletëkërkesa për përfshirje në listën zyrtare do të pranohet nëse lloji i farës: (a) specifikohet me emër; (b) dallohet nga të gjitha llojet tjera të farërave të pranuar apo të njohura; (c) është unik sa i përket strukturës së përbërësve; (d) është i qëndrueshëm; dhe (e) nëse lloji i kulturës bujqësore është në listën e familjeve botanike dhe të llojeve të farërave që qeverisen me ligj.

Ministria e Bujqësisë do ta autorizojë subjektin, i cili do t'i testojë veçoritë dalluese, trajtën dhe qëndrueshmërinë e llojit të farës. Veç kësaj, me këtë ligj rregullohet edhe kontrollimi i prodhimeve, çertifikimi i tyre, testimi, vënja e tyre në treg dhe importimi i farërave dhe rasatit për patate.

Kuvendi e aprovoi këtë ligj më 20 mars 2003, ndërsa PSSP e dekretoi më 15 prill 2003.

Ligji mbi kooperativat bujqësore

Pikësynimi i këtij projektligji është që ta bëjë rregullimin e kooperativave bujqësore, përfshirë këtu edhe aktivitetet dhe rolin e tyre në zhvillimin e bujqësisë. Në planin afatshkurtër, përmes këtij ligji synohet të shtohet efikasiteti i punës së bujqve. Kooperativa bujqësore është subjekt ligjor që krijohet nga subjektet natyrale dhe ligjore, për kapitalin e së cilës kontributin e tyre duhet të japin të gjithë bujqit. Nga çdo kooperativë bujqësore që themelohet në Kosovë, kërkohet që të regjistrohet para se t'i lejohet ushtrimi i aktiviteteve.

Kooperativa do t'i ketë të drejtat dhe detyrat e një subjekti ligjor të pavarur nga anëtarët e saj, do ta ketë pronën dhe detyrat e saj dhe do të jetë përgjegjëse për pronën e saj dhe për çdo veprim që ndërmerret në emër të saj.

Projektligji poashtu parasheh themelimin e kuvendit të kooperativës, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kooperativës, ndarjen e kapitalit dhe kontributet që duhet dhënë për këtë kapital, thirrjen e kuvendeve të përgjithshme vjetore, punën e revizorit të jashtëm, të komisionit drejtues dhe të kryetarit apo drejtorit të kooperativës. Në aspektin ekonomik, ky projektligj përfshin standardet për ndarjen e të hyrave dhe të dalave, shuarjen e kooperativave, nëse ka nevojë, bashkimin apo ndarjen e tyre, krijimin e bashkësive të kooperativave, punën e ndërmarrjeve subvencionuese apo anëtare si dhe masat e mundshme ndëshkuese, nëse shkilen rregullat apo udhëzimet e ndryshme administrative mbi zbatimin e këtij ligji.

Një dispozitë tjetër me rëndësi që përmban ky

projektligj është ajo ku parashihet që çdo kooperativë bujqësore, e cila do të jetë duke e zhvilluar aktivitetin e saj në kohën kur ky ligj do të vihet në fuqi, do të jetë e detyruar të regjistrohet në afat prej një viti, në të kundërtën do ta humbasë statusin e kooperativës bujqësore.

Pas shqyrtimit të parë më 17 prill 2003, komisionet e Kuvendit janë duke e rishqyrtuar këtë projektligj.

Ligji mbi plehrat

Projektligji mbi plehrat do t'i përcaktojë rregullat dhe një sistem rregullativ që do të qeverisë dhe do t'i mbrojë të drejtat e prodhuesve dhe të konsumatorëve të plehrave. 'Pleh' quhet substanca organike apo joorganike, e cila përmban një apo më shumë lëndë të njohura ushqyese për një bimë, që përdoret si ushqim për bimët dhe që është parashikuar të përdoret, apo thuhet se është e dobishme, për kultivimin e bimëve.

Në përgjithësi, qëllimi i këtij ligji është që të ruhet cilësia e plehrave. Çdo person - përfshirë prodhuesin, importuesin apo tregtarin - i

cili përpiqet ta shes apo ta vë në shitje plehun, duhet të posedojë çertifikatën e regjistrimit, e cila mund të vlejë më së shumti tre vjet.

Ndalohet prodhimi, importimi, ripaketimi, distribuimi apo përdorimi i plehrave që nuk i plotësojnë kriteret e cilësisë, kushtet dhe standardet tjera të përcaktuara me ligj. Për shembull, edhe nëse mund të përdoret sipas këtyre udhëzimeve, plehu mund të mos përmbajë lëndë të mjaftueshme ushqyese apo mund të përmbajë lëndë apo materie të rrezikshme për kultivimin e bimëve.

Përveç kësaj, do të emërohen inspektorë dhe analistë, të cilët do të përkujdesen për zbatimin e këtij ligji dhe do të jenë të autorizuar të japin urdhëra për ndërprerjen e shitjes së plehrave, konfiskimin, shqiptimin e dënimeve si dhe zbritjen e çmimit të shitjes së plehrave. Pos kësaj, ata do të kenë të drejtë të marrin masa tjera ndëshkuese në rast se ky ligj shkellet.

Pas shqyrtimit të parë më 24 prill 2003, komisionet e Kuvendit janë duke e rishqyrtuar këtë projektligj.

DJALOSHI QË NGUTET TA PËRMIRËSOJË GJENDJEN E SHKOLLIMIT

Hajredin Kuqi, 31 vjeçar, kryesues i Komisionit të Kuvendit për Arsim, është drejtuesi kryesor në debatin mjaft kontraverz mbi ligjin për shkollimin e lartë. Poul Smidt zhvilloi një bisedë me të lidhur me këtë debat si dhe me çështje tjera.

Intervistën zhvilloi: Poul Smidt

Hajredin Kuqi është një djalosh i ri, i cili ngutet ta realizojë një qëllim. Ai dëshiron ta ndryshojë dhe ta përmirësojë sistemin e shkollimit në Kosovë. Si 31 vjeçar, ai është anëtar i ri dhe njëherësh kryesues i Komisionit për Arsim të Kuvendit të Kosovës. Ai është krenar dhe ka arsye për këtë. "Në komisionin tonë kemi raporte mjaft të mira pune dhe thuaja se s'kemi fare kundërtënie," thekson ai. "Jam i befasuar, por edhe i lumtur me respektin që janë duke treguar ndaj meje anëtarët tjerë të komisionit, përfshirë këtu edhe disa profesorë me përvojë. Komisioni ynë është ndër komisionet më profesionale të Kuvendit."

Ai arriti deri te pozita e profesorit të drejtësisë në Universitetin e Prishtinës pasi që kaloi një rrugë të gjatë dhe pas një përvojë të konsiderueshme akademike ndërkombëtare që e kishte fituar gjatë shkollimit jashtë vendit. Studioi në Universitetin e Bilkentit, universitet

amerikan me qendër në Ankara, dhe më pas i vazhdoi studimet në shkollat më me zë në fushën e drejtësisë, si në Univesitetin e Georgetown-it në Washington D.C. - dhe së fundi në Grac të Austrisë. Që nga viti 1999, ai ka qenë nënkryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ndërkaq kohët e fundit PDK-ja ia ka besuar edhe disa përgjegjësi shtesë, siç janë çështjet publike, etj.

Ju nuk mund të bisedoni aq gjatë me Hajredin Kuqi, pa ju rënë në sy menjëherë se ai është i dashuruar në familjen e tij dhe në lirinë e tij akademike. Sidoqoftë, ai pohon se politika është diçka tjetër, madje ndoshta edhe diç e përkohshme, një obligim për të kontribuar për ndryshimet që po ndodhin gjatë këtyre kohërave të vështira nëpër të cilat po kalon Kosova. Mbase ka të drejtë, por me sa duket ai gabon në mënyrën se si e vlerëson marrjen e tij me politikë dhe bërjen e politikës. Prandaj, nëse keni rastin

të bisedoni me të vetëm për pak kohë, do të krijoni përshtypjen se politikën e ka në shpirt. Këtë e vërejtja qysh në fillim të bisedës që e zhvillova me të lidhur me detyrat e tij si kryesues, dhe me punën e Kuvendit në përgjithësi. Përvoja e tij si student i shkencave politike dhe si redaktor i një reviste për student na bënë që të kuptojmë se ai jo vetëm që është politikan i rrysur, por njëherësh shërben edhe për të konfirmuar se Hajredin Kuqi është politikan i mirëfillët.

A kemi sistem të politizuar të shkollimit në Kosovë?

Jo drejtpërsëdrejti, por disa përpiqen ta shfrytëzojnë për qëllime të tilla.

Ju thoni se komisioni juaj është ndër komisionet më të profesionale të Kuvendit, por a nuk mendoni se në Kosovë ka shumë mësues dhe profesorë që merren me politikë?

Ndoshta nganjëherë, por është me rëndësi ta dijim se institucionet e arsimit

kanë nevojë për mësim-dhënës.

Cila është çështja mbi të cilën më së shumti debatohet në komisionin tuaj?

Ligji mbi shkollimin e lartë.

Ligji të cilin PSSP nuk e ka nënshkruar, meqë ka qenë në kundërshti me Rezolutën 1244 apo me kornizën kushtetuese ...?

Mendoj se ky ligj duhet të dekretohet, sepse këtu është fjala vetëm për një nen, i cili është vënë në dyshim dhe andaj duhet të ulemi së bashku dhe ta zgjidhim këtë problem. Por, jam kundër një "Universiteti të Mitrovicës", i cili nuk do të jetë pjesë e sistemit të shkollimit në Kosovë.

Mund të thuhet se çështja e Universitetit të Tetovës ka qenë aq me rëndësi, sa që shumë shqiptarë do të kishin qenë të gatshëm të luftojnë për një Universitet në gjuhën shqipe në Tetovë, ndërkaq tash po e kundërshtoni

idenë e themelimit të një Universiteti në Mitrovicë, në të cilin do të fitej gjuha serbe ...

Këto dy raste nuk mund të krahasohen. Në Tetovë do të respektoheshin ligjet e Maqedonisë, përfshirë edhe ato mbi shkollimin.

A do t'i kishit vizituar fakultetet në Mitrovicën e veriut?

Po, por ata nuk do të më ftonin.

Çfarë propozoni ju që të tejkalojmë këtë situatë?

Duhet ta zgjidhim këtë çështje, duke e shqyrtuar atë si çështje të mirëfillët të shkollimit. Nëse në Mitrovicë i pranojnë ligjet vendore, atëherë ky problem merr fund. Në këto ligje vendore duhet të përfshihen dispozita të veçanta mbi punën e mësimdhënësve, tarifatat si dhe mbi ca çështje të tjera.

Unë do ta mbështesja aplikimin e tyre në Agjensinë për Akreditim të Ministrisë së Arsimit, por duhet patur parasysh se edhe pas



akreditimit ata nuk do të mund të përkrahen në mënyrë retrokative.

TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT DHE MINISTRIA

Si e vlerësoni nivelin e shkollimit profesional në universitetet?

Shumë pozitivisht, por duhet theksuar se tani për tani nuk jemi duke investuar sa duhet.

Kemi dëgjuar se studentët po e ngrisin zërin e tyre kundër tarifës mbi shkollim, duke pohuar se paratë që ata po i paguajnë po shkojnë në xhepa të gabuar, respektivisht në

xhepat e disa individëve. A është e vërtetë?

Është e vërtetë se Universitetit të Prishtinës i duhet xhirologaria e vet. Ne humbim mjaft kohë, nëse paratë duhet të kalojnë përmes Ministrisë ...

A është kjo mënyra se si ju, përmes parafrazimeve të sofistikuara, spekuloni lidhur me korrupsionin në arsim?

Jo, jam kundër korrupsionit dhe kundër spekulimeve mbi korrupsionin. Për akuza të tilla duhen dëshmi.

A posedoni ndonjë informacion lidhur me rastet kur emërimi i disa drejtoreve të shkollave ka mun-

dur të ketë prapavijë politike?

Po, ne i kemi marrë disa ankesa lidhur me këtë çështje, dhe prandaj ne menjëherë i kemi dërguar ministrin të Arsimit një letër zyrtare, përmes së cilës kemi kërkuar shqyrtimin e këtyre rasteve.

Çfarë janë mundësitë që bashkëpunimi midis Komisionit tuaj dhe Ministrisë së Arsimit e cila udhëhiqet nga LDK-ja të përmirësohet?

Ne jemi duke bashkëpunuar vazhdimisht me këtë ministri dhe ky bashkëpunim po funksionon mirë.

A mendeni ju, në kuadër të Komisionit tuaj, apo Ministrisë së Arsimit të gjejë ndonjë zgjidhje lidhur me problemet e pagave të ulëta për mesimdhënës apo gjendjen e pasigurt sociale? Mendoj se mundemi. Në kuadër të Komisionit tonë kemi zhvilluar diskutime mjaft konstruktive. Ne mund të diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhje, nëse mbi ne nuk ushtrohet presion.

HISTORIA, LIBRAT DHE PROBLEMET E MËDHA

Pasi ia shtruar shumë pyetje dhe pasiqë morëm një mori përgjigjesh, askush nuk mund të pohojë

se Hajredin Kuqi nxit problemet dhe kundërshtitë, por përkundrazi ai foli me aq diplomaci saqë për një çast mund t'ju bëjë të mendoni se sistemi i shkollimit në Kosovë është thjesht i përkryer. S'ka pikë dyshimi se nuk është, mirëpo Hajredin Kuqi s'duhet të pohojë se LDK dhe PDK po luftojnë për t'i bërë për vete të rinjtë, se fryma e LDK-së dominon në shkollat fillore dhe të mesme dhe se ajo e PDK-së është tejet e evidente në Universitet. Po ta pyesnit z. Kuqin se kush do ta shkruajë historinë e Kosovës, si përgjigje do ta merrnit një të qeshur, e cila do të mund ta rrezonte filxhanin nga tavolina modeste e kafeterisë së Kuvendit. Sidoqoftë, problemet janë evidente.

"Në të vërtetë, ende nuk kemi krijuar ndonjë strategji për zhvillimin e arsimit në Kosovë" thotë profesor Kuqi. "Ende po vazhdojmë me avazin e komunizmit. Po aftësojmë kadro, pa patur parasysh numrin e kadrove që na nevojiten. Nëse një i ri mbaron shkollën e mesme, ai nuk ka zgjidhje tjetër, pos t'ia mësyjë Universitetit. Me këtë shkallë të lartë të papunësisë, kjo duket të jetë zgjidhja e vetme e natyrshme për ta"

Çfarë është rëndësia e the-

melimit të paradokohshëm të Fakultetit të Arsimit?

Është hap shumë i rëndësishëm. Falë donacionit nga Kanadaja, tani mund t'i përgatisim mesimdhënësit që të japin mesim më mirë.

Por, megjithatë ju keni nevojë për literaturë dhe mjete më bashkëkohore në të gjitha nivelet e shkollimit?

S'do mend se pa libra, s'ka shkencë. Na janë dhënë shumë donacione, por nevojat tona janë shumë të mëdha. Problem tjetër paraqet profili i shkollave të mesme. Ne duhet ta ndryshojmë këtë sistem të shkollimit ashtu që shkollimi i mesëm të krijojë edhe mundësi tjera përpos vazhdimin të shkollimit në universitet. Shkollat e mesme teknike jetë vetëm një shembull i këtillë.

A do të jenë nxënësit të detyruar të mësojnë për vlerat e UÇK-së dhe në çfarë niveli?

Vlerat e UÇK-së janë pjesë e rëndësishme e historisë sonë të vonshme. Në të vërtetë, pjesa më e rëndësishme e historisë sonë. Ne duhet ta ndërtojmë historinë tonë, duke e çmuar atë e asses duke e anashkaluar ose pakësuar rëndësinë e saj si pjesë përbërëse të shkollimit.

KRYEMINISTRI I DREJTOHET KUVENDIT TË KOSOVËS

Një vit pas fillimit të punës së qeverisë, më 13 mars 2003, Kryeministri i Kosovës, Dr. Bajram Rexhepi, iu drejtua Kuvendit të Kosovës. Më 3 prill 2003 Kuvendi mbajti një debat të gjërë lidhur me aktivitetet dhe përgjegjësitë e qeverisë. Në vijim kemi paraqitur një rezymë të prezantimit të Kryeministrit.

Krijimi i qeverisë, si rezultat i Marrëveshjes së 28 shkurtit 2002 ndërmjet partive më të mëdha që përfaqësohen në Parlament, ka krijuar një bazë të fortë për funksionimin e institucioneve të Kosovës, të njohura dhe të pranura nga bashkësia ndërkombëtare.

Qeveria është konsoliduar dhe ka filluar procedurat e hartimit të ligjeve, në mënyrë që të përballet me nevojat e shoqërisë sonë. Deri më tani, Kuvendit i janë paraqitur 18 ligje. Ndërkaq, edhe 20 ligje të tjera janë në fazën përfundimtare të hartimit në qeveri dhe së shpejti do t'i dorëzohen Kuvendit për shqyrtim. Të gjithë i kemi të qarta vështirësitë me të cilat ballafaqohemi në procedurat e hartimit të ligjeve dhe miratimit të tyre.

Ne duhet të jemi objektiv në vlerësimin e asaj që kemi bërë dhe të pengesave që duhet t'i tejkalojmë. Bashkësia Ndërkombëtare është duke e redukuar praninë e saj në Kosovë. Në ditët dhe muajt e ardhshëm neve do të na jepen më shumë kompetenca, me çka do të vihen në provë aftësitë tona. Konkretisht, kemi mbajtur takimet tona të para me PSSP-në në lidhje me bartjen e kompetencave. Qeveria e Kosovës ka përpi-

luar një strategji sa i përket bartjes së kompetencave në sferat që ajo i ka vlerësuar të domosdoshme. Në këtë drejtim, qeveria ka kërkuar kompetenca në ndërmarrjet publike - PTK, KEK, formimin e një kompanie ajrore, frekuencat, çështjet e privatizimit, lëshimin e dokumentacionit - duke patur gjithmonë parasysh shqiptarët që jetojnë në shtetet e jashtëme. Njëherësh kemi bërë thirrje për një bashkëpunim më të ngushtë midis UNMIK-ut dhe qeverisë në sferat në të cilat kompetencat janë rezervuar për PSSP-në. Në fakt, ne kërkojmë pjesëmarrje në lëmin e politikës së jashtme, punëve të brendshme, sistemin e drejtësisë, çështjet e sigurisë, çështjet e furnizimit me energji elektrike, miniera, etj.

Qeveria është ballafaquar dhe do të ballafaqohet me shumë sfida gjatë viteve të ardhshme. Para së gjithash, nëpunësit tanë civilë kanë nevojë për trajnim dhe këshilla. Ata poashtu duhen të kenë paga më të larta. Veç kësaj, ne dëshirojmë që femijtë tanë t'i mësojnë dhe shkollojnë mësimdhënësit më të mirë, në mënyrë që ata pastaj të jenë në gjendje ta shfrytëzojnë potencialin e tyre. Njëkohësisht, ne dëshirojmë që nëpunësit e shërbimit tonë mjekësor të



jenë të përgjegjshëm dhe që jeta sportive dhe kulturore të jetë më e begatshme. Dëshirojmë poashtu që rinia jonë të ketë më shumë mundësi dhe hapësirë për t'u marrë me aktivitete të llojllojshme.

Ekonomia jonë varet nga shumë faktorë. Prandaj, ne kemi krijuar strategjinë tonë për t'u përballur me këto vështirësi të zhvillimit ekonomik, duke i inkurajuar pikë së pari investuesit e brendshëm dhe të jashtëm që të investojnë në ndërmarrjet prodhuese. Vartësia e skajshme nga importi, me të cilën jemi duke u ballafaquar, është e padurueshme. Shumica e artikujve që importohen nga jashtë, mund të prodhohen edhe këtu. Bizneset tona gjithashtu mund të prodhojnë mallra për tregjet e jashtëme. Së këndejmi, ne duhet të kërkojmë heqjen e pengesave për eksportim nga Kosova.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore ka filluar dhe ne do të bëjmë çështje e mundur për t'i tërhequr investuesit dhe për t'i nxitur ata që të krijojnë ndërmarrje private prodhuese, të cilat afër mendsh do të sillnin teknologji të re në vend. Në vazhden e këtyre përpjekjeve, neve patjetër do të nevojiten ndihma e institucioneve ndërkombëtare financiare.

Tani duhet t'i përvishemi edhe një punë tjetër. Ne e dimë se çështja e statusit përfundimtar të Kosovës duhet të shqyrtohet në mënyrë të drejtpërdrejt një ditë prej ditësh, veçse kjo duhet të bëhet në një moment të përshtatshëm për bashkësinë ndërkombëtare. Duhet të përgatitemi për çastin kur bashkësia ndërkombëtare do të ulët rreth tryezës me ne, Serbinë dhe Malin e Zi, për ta zaxhithur këtë çështje, e cila është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe si për ekzistencën tonë, ashtu edhe për të ardhmen tonë. Pjesërisht, kjo ka të bëjë edhe me konsolidimin e shoqërisë demokratike, të cilën jemi duke e ndërtuar. Poashtu, ka të bëjë edhe me krijimin e një ekonomie, që qytetarëve tanë do t'u siguronte një jetë më të mirë. Në një masë të caktuar, ka të bëjë edhe me të kaluarën tonë dhe me ndasitë tona në baza etnike, që do

të vazhdojnë ta dobësojnë gjendjen e sigurisë.

Kërkesa për dialog midis Beogradit dhe Prishtinës tani është aktuale. Për shkaqe, siç thuhet praktike këtu do të përfshihen edhe përfaqësuesit e institucioneve kombëtare. Temat për diskutim që janë caktuar nga Z. Steiner, janë diskutuar disa herë edhe në të kaluarën nga Beogradi dhe Prishtina. Shtrohet pyetja, çfarë kërkohet nga ne? Brenda vetëm 7 ditëve, Beogradi filloi ta trajtojë çështjen e dialogut me parashtrimin e ca kërkesave teknike dhe e përfundoi me ndarjen e Kosovës. Nuk është vështirë të kuptohet se vendi ynë fqinjë Serbia nuk është e interesuar për dialog rreth çështjeve teknike apo statusit përfundimtar të Kosovës, por është thjeshtë e interesuar ta ndajë Kosovën dhe kjo po bëhet çdo ditë e më qartë.

Qëllimet e Beogradit tanimë janë të njohura si për qytetarët e Kosovës, ashtu edhe për subjektet politike dhe institucionet e saj. Sido mend se ky fakt të frikëson, prandaj ne kërkojmë ndihmë nga faktorët ndërkombëtarë, në veçanti nga SHBA-të, Nju Jorku dhe Brukseli, që të mos e lejojnë vendin tonë fqinjë, Serbinë, që të vazhdojë ta shfrytëzojë Kosovën si mjet politik në favor të politikës

së saj. Dialogu duhet të përqëndrohet në një strategji të qartë institucionale, me ç'rast nuk do të viheshin në dyshim kompetencat e institucioneve të Kosovës.

Sidoqoftë, qeveria e Kosovës do ta përqëndrojë tërë energjinë e saj gjatë vitit të ardhshëm të qeverisjes në zhvillimin politik, në investime dhe në hapjen e vendeve të reja pune, (posaçërisht në bujqësi). Është e ditur se kjo është mënyra e vetme për të krijuar më shumë vende të lira pune, për ta vazhduar krijimin e administratës publike, për t'i integruar minoritetet (në veçanti minoritetin serb), në të gjitha sferat e jetës, për të pasur pushtet funksional ligjor në Kosovë dhe për ta inicuar themelimin e ministrive të reja.

Struktura ligjore vazhdon të jetë prioritet yni, ndaj ne do të bëjmë çmos që ta kemi një kushtetutë për Kosovën sa më parë që të jetë e mundur, në mënyrë që Kosovën ta bëjmë vend në të cilin do të funksionojë dhe do të respektohet ligji dhe në të cilin të gjitha institucionet demokratike do të jenë në shërbim të qytetarëve. Kjo është mënyra se si ne i qasemi çështjes së marrjes së kompetencave nga UNMIK-u dhe PSSP-ja. Në Kosovë nuk mund të ketë qeveri paralele, pos qeverisë së legjitimuar nga votat e qytetarëve të saj.

Bajram Rexhepi
Kryeministër i Kosovës.

AER-i OFRON PËRKRAHJE NË PROCESIN LEGJISLATIV

Bashkësia Evropiane, përmes Agjencisë Evropiane për Rindërtim (AER), ka filluar me implementimin e një programi ambicioz për përkrahje Zyrës së Kryeministrit (ZKM). Programi synon që të kontribuojë në përmirësimin e procesit legjislativ, hartimin e ligjeve, trajnimin, formimin e një shërbimi funksional të përkthimit dhe ndihmën që duhet ofruar për krijimin e një rrjeti të ekspertizave që do të vihej në shërbim të ZKM-së.

Miro Prek, udhëheqës i ekipit të AER/GTZ-së për mbështetje Zyrës së Kryeministrit

Ky program është duke u realizuar nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Teknik (GTZ) dhe partnerët e tij. Struktura qendrore e ekipit përbëhet nga një udhëheqës i ekipit, një ekspert ligjor dhe një ekspert përkthimi.

Me programin për ndihmë teknike do të ofrohen këshilla dhe ekspertizë përmes angazhimit afatshkurtë të ekspertëve në sferat e veçanta të veprimtarive në Kosovë. Mbase synimi më ambicioz i këtij programi është që t'i thellojë marrëdhëniet me ekspertët ligjorë vendas dhe t'i angazhojë ata në aktivitetet për mbështetje Kuvendit barabarë me ekspertët ndërkombëtarë. AER dëshiron të sigurojë për Kosovën një legjislacion që do të jetë në përputhje me "Acquis Communautaire" të BE-së.

Që nga 20 janari, kur u themelua Zyra e Kryeministrit, ky ekip ka marrë pjesë në grupet legjislativë që kanë punuar në projektligjin mbi prokurimin publik, projektligjin mbi qasjen në dokumentet publike si dhe në projektligjin për shëndet dhe siguri në punë. Kjo përkrahje është ofruar në formë të rishqyrtimit ligjor

dhe gjuhësor të projektligjeve, konsultave me OJQ-të lokale dhe me Institutin Kombëtar Demokratik (NDI) si dhe të përgatitjes për një memorandum sqarues (përfshirë përkthimin dhe rishqyrtimin ligjor). Përveç kësaj, është ndihmuar edhe me ofrimin e mendimit ligjor lidhur me përputhshmërinë e projektligjit mbi shëndet dhe siguri në punë me kriteret evropiane.

Komisioni drejtues i projektit të AER-it përbëhet nga përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit, AER-it dhe Shtyllës IV të UNMIK-ut. Më 31 mars, ky komision i aprovoi kushtet e punës për një varg projektshesh. Këtu përfshihen përgatitja e projektligjeve për kodin e shërbimit civil, pronësinë intelektuale, ligjin mbi kompanitë, ligjin mbi sistemet e evidentimit si dhe ligjin mbi trafikimin e paligjshëm të drogave. Për më tepër, projekti i AER-it synon krijimin e një baze ligjore të të dhënave, dhe formulimin e një strategjie për zhvillimin e sistemit ligjor në Kosovë si dhe dhënien e ndihmës për të mbështetur zhvillimin e përgjithshëm të legjislacionit.

Ekipi i projektit është duke

bërë përgatitjet e nevojshme për të organizuar implementimin e projekteve, duke përfshirë angazhimin e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Njëherësh, ky ekip është duke bërë përgatitjet e duhura, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të Komisionit Drejtues, që do të mbahet më 8 maj 2003, të miratohen kushtet e punës.

Parashikohet që në të ardhmen të ofrohet mbështetje në këto sfera: në hartimin e projektligjeve mbi ndërtimtarinë, të një kornize për rregulloret dhe standardet teknike (rrugët dhe urat), të një projektligji mbi transmetimin si dhe të një projektligji mbi një gazetë zyrtare për publikimin e ligjeve të dekretuara. Krahas kësaj, është planifikuar edhe mbështetja për krijimin e legjislacionit mbi administrimin publik (ligji mbi procedurën e përgjithëshme administrative, ligji mbi administratën dhe ligji mbi qeverinë).

Veç kësaj, në aktivitetet tjera duhet të përfshihet edhe një strategji për luftimin e korrupsionit si dhe rishikimin e Rregullores së Punës së Qeverisë.

Është rënë dakord që hapi i

parë që duhet ndërmarrur nga ekspertët ndërkombëtarë të jetë vlerësimi i nevojave për trajnim dhe aftësim të kuadrove, me fokus të veçantë mbi shërbimet ligjore që ofrohen në Zyrën e Kryeministrit si dhe çështjet e organizimit të procedurave në Zyrën e Shërbimeve për Mbështetje Ligjore dhe në Zyrën e Kryeministrit.

Në të njëjtën kohë është bërë vlerësimi i kapacitetit për përkthim të kuadrove gjuhësore të ZKM-së. Është propozuar që të krijohet një strukturë e re e kuadrove në ZKM dhe të punësohen edhe disa lektorë për gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, në mënyrë që të përmbushen kërkesat për shërbime të përkthimit. Përkthyesve janë duke u ofruar trajnime speciale.

Kanë filluar kontaktet dhe bashkëpunimi në mes të Iniciativës për Mbështetje Kuvendit (ASI-n) dhe Institutit Demokratik Kombëtar (NDI-në) në Kosovë si dhe me NDI-në e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, në mënyrë që përmes përpjekjeve të përbashkëta, të përpilohet një fjalor zyrtar i termave ligjore dhe parlamentare.

“NE DUHET T’I MBROJMË NJERËZIT MË TË NDIESHËM DHE MË TË VARFËR”

Stojanka Petković është kryesuese e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin e Kosovës. Ajo është anëtare e “Koalicionit Kthimi”. Meqë Kuvendi është duke pritur që t’i dorëzohen ca draft ligje mbi çështjet sociale, znj. Petković me këtë rast bëri një analizë të situatës sociale në Kosovë.

Intervistën e përgatiti Snezana Petrusiq

Cilat janë problemet kryesore sociale, sipas jush, me të cilat Kosova ballafaqohet në këtë moment?

Problemet kryesore me të cilat përballen të gjitha komunitetet e Kosovës janë para së gjithash varfëria dhe papunësia. Shumica e popullatës së Kosovës është e papunë. Një numër i konsiderueshëm i punëtorëve ose e ka lënë punën ose është larguar nga puna. Thënë troç shumica prej tyre tani kanë mbetur rrugëve. Personat me probleme sociale janë kryesisht njerëz që mbajnë familje, shumica prej të cilëve janë të moshës rreth dyzetvjeçare. Ata bëjnë çmos për t’iu siguruar ekzistencën familjeve të tyre. Ata lëre që nuk mund të gjejnë ndonjë punë tjetër, por nuk janë në gjendje t’i shfrytëzojnë as shërbimet e përkujdesjes sociale. Për më tepër, procesi i privatizimit mund të krijojë më shumë probleme sociale.

Deri në ç’masë e konsideroni problem përdorimin e drogave në mesin e të rinjve në Kosovë?

Pa pikë dyshimi është njëri prej problemeve kryesore nga i cili vuan shoqëria jonë. Një prej arsyeve kryesore është mungesa e ligjeve, kurse arsyet tjera janë pasojat e luftës, varfëria

dhe papunësia. Familja dhe shkolla janë një nga shtyllat kryesore për mbrojtjen e fëmijëve. Por shpesh, fëmijët sillen vërdallë pa ndonjë mbikqyrje nga të rriturit. Krahas problemit me drogat kemi edhe probleme tjera si krimi, trafikimi dhe prostitucioni. Të gjitha këto duhet të ndalohen nëse dëshirojmë ta mbrojmë shoqërinë tonë.

Cilat janë objektivat që Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale i ka vënë vetes për këtë vit?

Para së gjithash objektivi ynë kryesorë është të paralajmërojmë, të sinjalizojmë, të japim një rekomandime qeverisë së Kosovës që të përgatisë një program social që do të jetësohej pasi që të fillojë procesi i privatizimit. Ky program do të kishte për qëllim rregullimin e të drejtave të të gjithë punëtorëve. Nëse qeveria nuk e përgatitë një program të këtillë, atëherë mund të presim probleme të tjerë në fushën e punësimit.

Gjatë njërës nga mbledhjet e fundit të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale është debatuar edhe lidhur me “dispozitat mbi nevojat e veçanta” për njerëzit më të ndieshëm që kanë nevojë për ndihmë të tillë. Çfarë men-

doni se mund të arrihet lidhur me këtë çështje?

Si kryesuese e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, unë kam filluar një debat për përkrahjen financiare dhe mbrojtjen e atyre që kanë nevojë të veçanta, të atyre që nuk mund të kujdesen për vetveten. Të gjithë anëtarët e Komisionit përkrahin nisimën time. Jemi të mendimit që t’i bëhen propozime Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Qeverisë së Kosovës që të fillojnë hartimin e një ligji për zgjidhjen e problemeve dhe të rasteve me nevojë të veçanta, një ligj mbi përkujdesjen sociale.

Sa i takon çështjeve sociale, tani për tani ne kemi miratuar vetëm një ligj mbi pensionet dhe një tjetër mbi inspektimin e punës. Neve na duhet një ligj mbi nevojat e veçanta, ngase ne kemi njerëz të sëmurë, njerëz me trauma të luftës, kurse numri i atyre me sëmundje të kancerit është shtuar. Veç kësaj, një numër i këtyre njerëzve nuk kanë mbështetje të mjaftueshme financiare dhe ju mungojnë ndihmat si fjala vjen karrocet apo aparatet e dëgjimit. Poashtu nuk duhet harruar se njerëzit nuk kanë mjaft para që të paguajnë shpen-



zimet mjekësore, ndërsa shpenzimet duhet të kompënzohen. Prandaj, unë them se Ministria e Shëndetësisë duhet të angazhohet në këtë drejtim.

Ideja ime është që të përmbledh gjithë këtë në një projekt të ardhshëm dhe të ftojë në ndihmë OJQ-të e ndryshme që mirren me këto çështje. Këto OJQ janë përkujdesur për problemet sociale pas luftës, meqë ato kanë përvojë në këtë fushë. Në bashkëpunim me to, me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë dhe disa nga ekspertët, unë do të organizoj një tryezë të rrumbullakët mbi këtë temë me qëllim identifikimit të dispozitave që duhet të përfshihen në ligj.

Serbët, shqiptarët dhe komunitetet tjera kanë të njëjtat brengat kur bëhet fjalë

për luftimin e varfërisë. A është kjo një fushë në të cilën mund të ketë një bashkëpunim ndërpartiak?

Sigurisht. Unë them shpesh që problemet sociale i shqetësojnë të gjitha komunitetet. Kjo është çështje për të cilën nuk duhet bërë dallime etnike dhe kombëtare. Serbët, shqiptarët dhe komunitetet tjera duhet të gjejnë një interes të përbashkët në këtë fushë dhe të krijojnë një bashkëpunim të mirëfillt mbi bazën e vullnetit të mirë. Nëse dëshirojmë të kemi përparim në çështjet sociale, atëherë kjo çështje nuk duhet të politizohet. Problemet sociale prekin të gjitha komunitetet. Pavarësisht se a e shikojmë këto probleme nga prespektiva e komunitetit serb, apo nga ajo e komunitetit shqiptar, secili prej tyre do të insistojë që është në pozitë më të keqe. Unë i njoh problemet me të cilat komuniteti serb është duke u ballafaquar, ndërsa kolegët e mi shqiptarë e dinë se çfarë e brengos komunitetin e tyre. Edhe pse mund të kemi mendime të ndryshme mbi shumë çështje, do të apeloja për atë që për zgjidhjen e problemeve sociale duhet të bisedojmë me njëri tjetrin pa lejuar përzierjen e politikës në këto probleme.

SISTEMATIZIMI I MEKANIZMAVE PËR NJË EKONOMI KONKURUESE NË KOSOVË

Përpjekjet për krijimin e një ekonomije të re, produktive dhe kompetitive në Kosovë shënuan një kthesë në muajin mars, kur u tubuan ekspertët kryesor përfaqësues për marrjen e vendimeve nga sfera ekonomike për të diskutuar në një tryezë të rrumbullakët. Prandaj, organizuesit besojnë se tanimë është hapur shtegu për një bashkëveprim efikas dhe produktiv në kuadër të mekanizmave qeveritare në Kosovë.

Mustafa Eric

Paralajmërimet ishin të alarmante: Kosova prodhon vetëm një të tretat e të hyrave të saj; dy të tretat vijnë nga jashtë në formë të parave të dërguara prej donatorëve. Deficiti i tregut të Kosovës është më i madh se PPV-ja (GDP-ja) e tij; vlera e importit të tij është dhjetë herë më e madhe se e eksportit, kjo s'është në rregull. Njëkohësisht është me rëndësi të kihet parasysh se me fillimin e luftës në Irak dhe mobilizimin e pritur të ndihmave ndërkombëtare për rindërtimin e këtij vendi, përkrahja financiare për Kosovën do të zvogëlohet në një të ardhme jo të largët. Shkëmbimi i mendimeve ishte i hapur: përpjekjet për krijimin e një legjislacioni për të bërë të mundur një përparim më të shpejtë, më sistematik dhe më të qëndrueshëm ekonomik, janë më se të domosdoshme. Mirëpo, përpjekjet për krijimin e një legjislacioni të tillë janë duke hasur në pengesa, ngase ato i kthehen Kuvendit për rishqyrtim, madje pa ndonjë koment se pse duhet të rishqyrtohen. Ky takim ishte një ngjarje e veçantë: seminari i organizuar nga Friedrich Nau-

mann Stiftung (FNSt.) me ish Sekretarin e Shtetit Gjerman për Ekonomi, Z. Klaus Buenger dhe OSBE-në në kuadër të Iniciativës për Përkrahje Kuvendit ASI (IPK). Në të u tubuan përfaqësuesit e të gjitha shtyllave kryesore të qeverisjes në Kosovë. Pjesëmarrës ishin komisionet e Kuvendit nga fushat e tregtisë dhe industrisë, financave dhe ekonomisë si dhe Komisioni për Buxhet, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministri për Ekonomi dhe Financa, shtylla e katërt e UNMIK-ut si dhe OJQ-të vendore të cilat ishin të interesuara për aktivitetet ekonomike.

Juergen Voss, prej shtyllës së UE-së duke folur në emër të administratës së UNMIK-ut, haptazi iu tha pjesëmarrësve se Kosova duhet ta kuptojë seriozitetin e situatës dhe të fillojë të mobilizoj të gjitha burimet në mënyrë që të krijojë vende të lira të punës dhe të ardhura. Ai theksoi se roli i privatizimit është i një rëndësie parësore, për të siguruar që Kosova të ketë një ekonomi konkurruese, dhe të integruar në tregun e Ballkanit. Ai gjithashtu theksoi se reforma bankare dhe ndërtimi i infrastrukturës, janë të domosdoshme

për tërheqjen e investoreve të huaj, kurse për të arritur një nivel konkurrues në tregun rajonal dhe ndërkombëtarë nevojitet një përqëndrim përpjekjesh.

Ministri për Financa dhe Ekonomi Z. Ali Sadriu, duke bërë fjalë për të arriturat në mbledhjen e taksave tha: "Buxheti i Kosovës, i cili në vitin 1999 plotësisht financohej nga donatorët, në 2003, do të financohet pothuajse krejtësisht nga taksapaguesit kosovarë", ai paraprakisht njoftoi se "...Ende ekziston një disproporcion në mes të të ardhurave të mbledhura nga taksat e doganës dhe atyre të mbledhura në Kosovë. Mund të thuhet se vjelja e taksave brenda territorit të Kosovës është ende e pamjaftueshme dhe në një shkallë të ulët. Përdërisa kjo shpërputhje të mos ndryshohet do të jetë shumë vështirë të sigurohet një buxhet i qëndrueshëm".

Ministri për Tregti dhe Industri Z. Ali Jakupi, në anën tjetër, vuri në dukje se "...ende nuk janë miratuar ligjet që legalizojnë konkurrencën". Z. Jakupi, në fjalën e tij, u përqëndrua në nevojën e krijimit të parakushteve për një konkurrencë me anë të rregu-

llimit të mjedisit ekonomik. Ai tha se "Legjislacioni ekonomik, siç janë ligjet mbi konkurrencën, anti-korrupsionin, mbrojtjen e konsumatorit, tregun e huaj dhe të vendit, prodhimet e naftës dhe doganat," janë çështjet me prioritet që duhet të shqyrtohen urgjentisht.

Kryesuesi dhe anëtarët e komisioneve të Kuvendit të cilët morrën pjesë në këtë seminar, ranë dakord për nevojën për përsheptimin e krijimit të legjislacionit, me qëllim të stabilizimit të ekonomisë. Megjithatë, ata u ankuan se aktet legjislative tashmë të miratuara, i janë kthyer Kuvendit për rishqyrtim pas një vonese të rishqyrtimit të tyre. Haki Shatri, kryesues i Komisionit për Buxhet, vuri në dukje se është e vërtetë se legjislacioni është i domosdoshëm, por ai njëkohësisht theksoi se është më me rëndësi të mobilizohet fuqia prodhuese, e cilat do t'i mundësojë ekonomisë lokale që të krijojë vende të lira të punës dhe të ardhura materiale. Slobodan Bjelic, kryesues i Komisionit për Ekonomi dhe Financa, vuri në dukje se promovimi i standardeve evropiane ka rëndësi të madhe për arritjen

e fuqisë konkurruese, por për këtë është i domosdoshëm stabiliteti politik.

Me fjalë të tjera, në këtë mbledhje nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar si të vazhdohet më tutje apo si të hartohet një strategji për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës. Sidoqoftë, në mesin e pjesëmarrësve u arrit konsensusi për fillimin e pavarësisimit të institucioneve të Kosovës nga varshmëria e tyre prej donatorëve të huaj dhe për ndërtimin e strukturave të domosdoshme që do të bënin të mundëshëm shfrytëzimin e burimeve vendore në mënyrë që të krijohet një ekonomi konkurruese.

Për arritjen e një konsensusi mbi përcaktimin e masave kryesore që duhet të ndërmerren, pa pikë dyshimi se duhet të mbahet një mbledhje tjetër apo seminar të llojit të tillë, pra një mbledhje e cila do t'i tubojë përfaqësuesit kryesorë të degëve legjislative dhe ekzekutive të mekanizmave qeveritare të Kosovës. Vetë fakti se këtu u hap shtegu për një dialog midis shtyllave kryesore për të ardhmen e ekonomisë, mund të konsiderohet se takimi solli rezultate të konsiderueshme.

AKTIVITETET E KOHËS SË FUNDIT NË PËRKRAHJE KUVENDIT

"Komunitetet tjera" themelojnë grupin e tyre parlamentar. Deputetët nga komunitetet joshqiptare dhe joserbe vendosën ta krijojnë grupin e tyre parlamentar. Kështu u vendos gjatë një takimi dyditor në Brezovicë, më 14-15 maj, i cili u mbështet nga Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së. Ambasadori Pascal Fieschi, Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë, iu drejtua parlamentarëve dhe përcolli ceremoninë formale që u organizua me rastin e themelimit të këtij grupi parlamentar. Para se ta publikonin vendimin e tyre në një konferencë për shtyp më 18 maj, deputetët e grupit të posaçmërisht parlamentar të "komuniteteve tjera" u pritën nga kryetari i Kuvendit, Prof. Daci, në zyrën e tij. Me këtë rast ai shprehu mirënjohjen e tij për grupin e ri parlamentar dhe bëri të ditur se ky grup parlamentar ishte themeluar konform Rregullores së Punës së Kuvendit. Ai njëherësh i këshilloi anëtarët e këtij grupi parlamentar që ta përvetësojnë një kulturë të vendimmarrjes së përbashkët, e cila do të ishte në funksion të të gjitha komuniteteve, ndonëse heterogjene për nga përkatësia e tyre etnike dhe politike.

Ky grup përbëhet nga 10 deputetë joshqiptarë dhe joserbë, çfarë e bën këtë grup parlamentar të katërtin me radhë në Kuvend për nga madhësia (pas LDK-së, PDK-së dhe KP-së). Në të vërtetë, grupi parlamentar i "komuniteteve tjera" përbëhet nga 4 boshnjakë, 1 goran, 3 turq, 1 ashkali dhe 1 rom. Egjiptianët nuk bëjnë pjesë në grupin parlamentar të "komuniteteve tjera", meqë vendosën t'i bashkohen grupit parlamentar të AAK-së.



Nga e majta në të djathtë: Xhezair Murati (VATAN), Zylfi Merxha (PREBK), Faik Marolli (PDASHK), Sadik Idrizi (VATAN) dhe Gani Sadik (KDP), gjatë një konference shtypi në Kuvend më 18 mars 2003.

Fondacioni holandez do t'u ofrojë këshilla partive që përfaqësohen në Kuvend

Projekti mbi praktikën parlamentare të fondacionit Lindje-Perendim (EWPPP) kohë më parë filloi implemtimin e një programi afatgjatë për përkrahje Kuvendit të Kosovës të quajtur, "Aspektet dhe teknikat e demokracisë parlamentare." Aktivitetet e programit përfshijnë një varg seminaresh ndërparlamentare që do të mbahen në Kosovë, ku përfshihen një seminar që do të mbahet në rajon dhe poashtu edhe një vizitë zyrtare në Kuvendin e Holandës në Hagë. Pjesë përbërëse e këtij programi janë edhe konsultat triditore midis (ish) deputetëve të Parlamentit të Holandës dhe homologëve të tyre nga Kuvendi i Kosovës. Tryeza e parë e rumbullakët mbi marrëdhëniet brendapartiake dhe jashtëpartiake në Kuvend do të mbahet më 9 maj në Prishtinë.

Konrad Adenauer Stiftung do ta mbështesë sektorin e arsimit

Më 20 maj, një delegacion nga fondacioni Konrad Adenauer Stiftung ishte në një mision hulumtues në Kosovë. U konstatua se mbështetja sektorit të arsimit do të duhej të jetë prioritet i këtij fondacioni gjerman. Do të hartohen programe specifike me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe me Komisionin për Arsim të Kuvendit të Kosovës. Diku kah fillimi i muajit korrik të këtij viti, fondacioni Konrad Adenauer Stiftung ka vendosur ta ftojë një delegacion të përbashkët të Kuvendit dhe qeverisë së Kosovës në një vizitë zyrtare në Gjermani, ku do të bisedohet mbi çështjet e arsimit.

Në mes të marginalizimit dhe anëtarësimit në UE

Prej 11-13 prill 2003 Friedrich Ebert Stiftung (FES) së bashku me Institutin Gjerman për Politikë Ndërkombëtare dhe Siguri dhe Akademinë e Protestantëve Titzung, organizuan konferencën me titull "Evropa Jug-Lindore në mes të marginalizimit dhe anëtarësimit në UE". Në këtë konferencë e cila u mbajt në Gjermani morën pjesë anëtarë nga mbarë Evropa Jug-Lindore. Në këtë konferencë morën pjesë edhe dy anëtarë të Kuvendit të Kosovës: Alush Gashi (LDK) dhe Hajredin Kuqi (PDK). Në konferencë u diskutua edhe mbi instrumentet dhe mekanizmat e komunitetit ndërkombëtarë, për krijimin e stabilitet në rajon, si Pakti i Stabilitetit, Agjensioni Evropian për Rindërtim, Procesi i Stabilizim-Asocimit, pastaj për pasojat e vijave kufitare të reja të Shengenit në mes të SEE-së, si dhe mbi bashkëpunimin rajonal në Ballkan.

Friedrich Ebert Stiftung organizoi vizitën e tri komisioneve të Kuvendit në Shqipëri

Gjatë javës së fundit të muajit prill, fondacioni Friedrich Ebert Stiftung organizoi një vizitë zyrtare në Shqipëri. Në këtë vizitë morën pjesë kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit e tri komisioneve të Kuvendit: Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komisionit për Shëndetësi dhe Komisionit për Ambient dhe Planifikim Hapësinor. Anëtarët e delegacionit nga Kuvendi i Kosovës, ku morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha grupeve më të mëdha parlamentare, zhvilluan diskutime intenzive dhe këmbyen përvojat me kryesuesit e komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë.

Po përgatitet fjalori i termeve parlamentare dhe ligjore

Sekretariati i Kuvendit dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë kanë iniciuar një projekt të përbashkët për përpilimin e "Fjalorit të termave parlamentare dhe ligjore." Ky fjalor do të jetë dokument ligjor dhe do të botohet në tri gjuhë (në shqip, serbisht dhe anglisht). Në të do të përfshihen termat parlamentare dhe ligjore që përdoren në organet legjislativë dhe qeveritare dhe do të ofrojë sqarime të plota për secilin term. Veç kësaj, janë paraparë edhe projekte të ngjashme me institucione dhe organizata të tjera në Kosovë, si: me Zyrën e Kryeministrit, Këshillin Ekonomik dhe Fiskal, Shërbimin e Përkthyesve të UNMIK-ut, Shtyllën I të UNMIK-ut (për Polici dhe Drejtësi), Grupin Finlandez për të Drejtat e Njeriut dhe me Institutin Demokratik Kombëtar (NDI). Projekti është iniciuar me qëllim që të zgjidhen problemet aktuale në krijimin e një Kuvendi funksional shumëgjuhësorë.

UNDP krijon arkivet elektronike për Kuvendin e Kosovës

Më 21 mars, UNDP ua prezantoi donatërëve të interesuar projektin e tij për krijimin e arkiveve për Kuvendin e Kosovës. Ky projekt përfshin procesverbalet, procesimin dhe arkivimin e procedimeve dhe seancave të Kuvendit, krijimin e sistemit për menaxhimin e dokumenteve si dhe për qasje në informata dhe shpërndarjen e tyre. Për shkak të përvojës ekspertizës në mbarë botën dhe kapacitetit teknik me të cilin mund të kontribuojë, projektin i është bashkangjitur edhe Unioni Ndërparlamentar (IPU). Projekti do të implementohet në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Kuvendit dhe në koordinim me ASI-n, AER-n, NDI-në, Ekspertizën Qeveritare Finlandeze dhe Ministrinë e Shërbimeve Publike. Për më shumë informata, shih <http://www.undp.org>

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut filloi mbikëqyrjen e punës së Kuvendit

Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMDLNJ), njëra nga OJQ-të e Kosovës që gëzon një reputacion të mirë, filloi zbatimin e një programi intenziv për mbikëqyrjen e punës së Kuvendit të Kosovës

dhe të 11 kuvendeve komunale. Në nivelin qendror, mbikëqyrësit e KMDLNJ-së filluan të përcjellin shumicën e takimeve të komisioneve të Kuvendit. Qëllimi i këtij monitorimi është që t'i jepet kredibilitet procesit politik në Kosovë përmes një qeverisje të përgjegjshme dhe transparente. Mbikëqyrja dhe vëzhgimi janë pjesë përbërëse e strategjisë së përgjithshme për përkrahje Kuvendit të Kosovës në çështjet që KMDLNJ i konsideron si preokupime kryesore të tij, siç është p.sh. respektimi i të drejtave të njeriut. Ky projekt është duke u sponsorizuar nga OSBE-ja dhe NDI-ja. Raporti i parë mbi këtë projekt do të publikohet gjatë muajit maj 2003 në faqen e internetit: www.cdhrf.org.

Studentët e Universitetit të Prishtinës marrin pjesë në sesionet e Kuvendit

Studentët e Fakultetit të Shkencave Politike të Universitetit të Prishtinës filluan të marrin pjesë në sesionet plenare të Kuvendit të Kosovës. OSBE-ja dhe Sekretariati i Kuvendit të Kosovës janë duke u ndihmuar studentëve që çdo javë të marrin pjesë në këto sesione. Kjo nisimë konsiderohet si shumë e rëndësishme për studentët e këtij fakulteti dhe është në përputhje me Rregulloren e Punës në të cilën thuhet se "...sesionet e Kuvendit duhet të jenë publike."

Komisioni për Barazi Gjinore thirri mbledhjen e koordinimit

Më 25 mars, Komisioni për Barazi Gjinore i ftoi organizatat ndërkombëtare që merren me çështjet e barazisë gjinore në një mbledhje koordinimi. Këtu morën pjesë OSBE-ja, UNIFEM-i, Zyra për Çështje Gjinore e UNMIK-ut (OGA), fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile (KCSF), STAR Network dhe Zyra Këshilldhënëse për Qeverisje të mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje të Barazisë Gjinore (nga Zyra e Kryeministrit). Komisioni kërkoi që t'i ofrohej ndihmë përmes sigurimit të ligjeve nga vendet e ndryshme demokratike dhe angazhimit të ekspertëve.

Gjerë më tani, janë përkthyer tetë ligje, të cilët u janë dhënë Z/KM-së dhe këtij komisioni: ai i Sllovenisë, Bullgarisë, Lituaniës, Rumanisë, Finlandës, Kroacisë, Holandës dhe Bosnje e Hercegovinës. Këto ligje do të shfrytëzohen si dokumente dhe burime referuese për t'i ndërmarrë hapat e parë në hartimin e ligjit të Kosovës mbi barazinë gjinore. "Ky ligj nuk do të jetë vetëm kopje e këtyre ligjeve, por do të jetë ligj yni, që do të bazohet në realitetin në Kosovë. Ky ligj do të çojë kah themelimi i institucioneve për mbrojtjen e barazisë gjinore," tha Znj. Melihate Tërmkollit, kryesuese e Komisionit për Barazi Gjinore në Kuvendin e Kosovës. OSBE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje përmes angazhimit të ekspertëve dhe përkthimit të ligjeve. Kështu gjatë muajve prill dhe maj të këtij viti, KCSF-i planifikon të mbajë një seminar mbi planin strategjik të Komisionit për Barazi Gjinore për vitet 2003-2005 dhe një vizitë studimore në Slloveni dhe Bullgari.

PËR MEDIA PROFESIONALE DHE TË QËNDRUESHME NË KOSOVË

Gazetarë dhe ekspertë të mediave u mbledhën të shtunën, më 29 mars 2003, në Prishtinë në një konferencë për të diskutuar mbi të ardhmen e gazetarisë në Kosovë dhe mbi draftin e propozuar të ligjit për themelimin e Komisionit të Pavarur për (KPM).

Marie-Helene Verney, Këshilltare e Lartë e Mediave pranë OSBE-së

Konferenca u organizua nga Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Kosovës me mbështetjen e OSBE-së. Konferencën e udhëhoqi Z. Baton Haxhiu, i cili aktualisht është kryesues i shoqatës, ndërsa e moderoi Z. Dukagjin Gorani.

Ambasadori i OSBE-së Pascal Fieschi hapi diskutimin me një fjalim ku theksoi rëndësinë e themelimit të një komisioni të pavarur, i cili do ta mbikëqyrte dhe do ta koordinonte punën e mediave elektronike në Kosovë. Ai me këtë rast vuri në spikamë se demokracia funksionale në një vend matet me vitalitetin dhe profesionalizmin e mediave të shtypura dhe elektronike. Ai poashtu tha se e ardhmja e institucioneve demokratike në Kosovë varet nga pavarësia e mediave të shtypura dhe elektronike në Kosovë dhe se OSBE-ja impenjohet shumë për të siguruar që çdo ligj i ardhshëm mbi transmetimin, t'u shërbejë jo vetëm interesave të mediave, por edhe interesave të njerëzve që jetojnë në Kosovë. Ambasadori Fieschi shprehu opinionin e tij se e ardhmja e trans-

metuesi publik, RTK-së, duhet të garantohet sepse duhet të jetë njëri ndër objektivat kryesore të ligjeve të reja mbi transmetimin. Së këndejmi, do të ishte me rëndësi që drafti i propozuar të jetë në përputhje me kriteret dhe me përvojat më të mira evropiane.

Z. Rexhep Hoti, këshilltar politik në zyrën e Kryeministrit, tha se një grup punues i ekspertëve do të fillojë së shpejti të mbajë mbledhje për të diskutuar lidhur me draftin e propozuar. Ky grup punues do të përbëhej nga përfaqësues të transmetuesve publikë dhe të atyre të pavarur, si dhe nga ekspertë ndërkombëtarë. Ai vuri në dukje se qeveria dëshiron të sigurojë transparencë gjatë tërë procesit të hartimit të ligjit - gjë e cila, sipas tij, ka munguar deri më tani. Ai tha se qeveria është e hapur ndaj sugjerimeve dhe se nuk përkrahë kurrfarë ligji i cili do të privilegjonte ndonjë transmetues, në dëm të tjerëve.

Njëra nga çështjet për të cilat më së shumti u diskutua gjatë debatit ishte ndërfutja në draft e një dispozite sipas të cilës

reklamimi në RTK duhet të reduktohet në zero, me të filluar funksionimi i pagesës së tarifës për RTK-ën përmes llogarive të KEK-ut. Z. Agim Zatriqi, Drejtor Gjeneral i RTK-së, mbajti një fjalim të fuqishëm me çrast tha "Zeroja që shkakton zero të tjetra" në RTK do të shpiente çdo transmetues publik në kolaps. Duke reguar ndaj fjalimit të Z. Zatriqit, Z. Hoti tha se qëllimi i ligjit mbi KPM-në nuk është që ta shkatërrojë asnjë transmetues, por që të gjithë transmetuesve t'ua ofrojë mundësitë e barabarta. Z. Zatriqi po ashtu shprehu shqetësimin e tij përkitazi me autoritetin që i jepet me draftin e propozuar drejtorit ekzekutiv të KPM-së për ta mbikëqyrur buxhetin e RTK-së.

Disa nga gazetarët e pranishëm në konferencë thanë se para se të debatohet mbi ligjin mbi KPM-në, do të duhej të diskutohej mbi rolin e KPM-së, dhe mbi atë se a ka nevojë apo jo për një KPM. Shumica ranë dakord se kishte nevojë për një organ rregullativ, mirëpo shtuan ata, kur është fjala për mediat e shtypura, një

mekanizëm i tillë jo vetëm se nuk ekziston, por as që është propozuar.

Z. Shkelzen Maliqi, nga instituti "Gani Bobi", hapi sesionin e pasdites, me një fjalim që tingëlloi si kumbonë paralajmërimi qortues për gazetarët e Kosovës. Ai shprehu dronë se gazetaria në Kosovë po hynte në një periudhë mjaft të vështirë dhe se kriza do të vërehet më shumë kur do të fillojnë të ndërpriten ndihmat financiare nga ndërkombëtarët. Shumë transmetues në Kosovë, vazhdoi ai, nuk do të mund të ekzistojnë pa ndihmën e ndërkombëtarëve. Ai shtoi se shkalla e konkurrencës ndërmjet transmetuesve dhe mungesa e solidaritetit

në profesion do ta bëjnë krizën akoma më të rëndë.

Shumica e të pranishmëve ishin të mendimit se gazetarët në Kosovë duhet të bëjnë më tepër për një vetorganizim më të mirë, dhe nëse ata nuk janë të aftë të paraqesin një front unik, zëri i tyre nuk do të dëgjohet, kurse kushtet për ushtrimin e profesionit të tyre nuk do të përmirësohen. Nevoja do të fillojë të ndërpriten unjente për një shoqatë të fortë, të organizuar mirë dhe profesionale, hasi në përkrahje të gjerë. Shoqata e Gazetarëve Profesionistë planifikon të takohet përsëri në muajin prill për të diskutuar mbi kodin vullnetar të mirësjelljes për mediat e shtypura.



DREJT MARRDHËNIEVE MË TË MIRA ME VOTUESIT PËRNGATITJET PËR NEGOCIATA

Indikatorët kryesor të progresit drejt krijimit të dialogut midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në demokracitë e reja në zhvillim, janë marrëdhëniet e mira me votuesit. Marrëdhëniet me votuesit iu bëjmë të mundshëm përfaqësuesve të zgjedhur që t'u ndihmojnë qytetarëve të cilët kanë votuar për një sistem demokratik. Mjerisht, në shumë sisteme të zgjedhjeve të përfaqësimit proporcional, anëtarët e zgjedhur të Parlamentit besojnë se ata para së gjithash duhet të jenë lojal ndaj partisë që i ka zgjedhur, dhe jo ndaj qytetarëve të cilët kanë votuar për ta.

Sherrie Wolff, Ph.D. Konsultant, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) ka zhvilluar seminare mbi marrëdhëniet me votuesit, për anëtarët e zgjedhur të kuvendit qendror, kuvendëve komunal dhe kryetarët e degëve të partive politike: LDK, PDK, AAK, partive serbe të Kosovës dhe partive që përfaqësojnë komunitetet më të vogla etnike dhe politike. Seminaret u zgjatën disa javë, në muajin prill dhe maj, 2003.

Gjatë këtyre seminareve zyrtarët e Kuvendit qendror dhe komunal si dhe ata të partive politike, janë ndarë sipas rajoneve të cilat i përfaqësojnë. Shpeshherë është vështirë të kombinohen zhvillimet e trajnimeve për secilin nga këto institucione njëkohësisht, por kjo është një mënyrë efiçente për pjesëmarrësit që të mësojnë të komunikojnë dhe koordinojnë një plan të plotë apo të integruar. Më pas, prej secilit grup do të kërkohet që të bashkëpunojë dhe të koordinojë aktivitetet mes tyre për të përcaktuar se cilët janë

ata që i përfaqësojnë këto grupe, përfaqësimin e grupeve kryesore, kushtet e edukimit dhe disa të dhëna specifike demografike për çdo rajon. Ata pastaj vazhduan me shkoqitjen e çështjeve dhe qëllimeve prioritare për atë rajon duke hartuar një plan strategjik të punës me afate kohore, me buxhet dhe me persona përgjegjës për implementimin e zotimeve të caktuara. Njëherësh, informatat për kontakt, u janë ofruar qytetarëve lokal në mënyrë që të mund të kontaktojnë. Seminaret vijuese do të ndihmojnë në zhvillimin e metejmë të metodave të përhapjes së informatave për qytetarët lidhur me atë se çfarë ndihme ata mund të presin realisht nga partia, ku mund të shkojnë për t'i shprehur shqetësimet, hallet dhe dëshirat e tyre, pra si mund t'i artikulojnë në mënyrë efektive këto nevoja.

Një prej pengesave kryesore sipas mendimit të anëtarëve të zgjedhur në mbarë botën është mungesa e

kohës, personelit dhe të hollave. Gjatë këtyre trajnimeve, diskutimet janë përqëndruar rreth rëndësisë për të mësuar për koordinimin e veprimeve dhe planeve për zyrtarët e zgjedhur dhe liderët e partive në mënyrë që të ofrohen shërbime sa më të mira për votuesit. Janë shpeshherë liderët e partive vendore ata të cilët janë përgjegjës për të siguruar një ndihmë më efektive.

Ishte kënaqësi për t'i parë pjesëmarrësit si përfshirë lokal në mënyrë që të mund të kontaktojnë. Seminaret vijuese do të ndihmojnë në zhvillimin e jetës së qytetarëve. Një pjesëmarrës pyeti nëse ai mund të merrte pjesë në të gjitha sesionet, pasi që, sipas tij, "unë kam shumë për të mësuar". Meqë seminaret e trajnimit për raportet me votuesit janë ofruar nga NDI-ja, këta pjesëmarrës duket se kishin një qëndrim shumë entuziast dhe gjithëpërfshirës për idenë mbi kontributin e tyre për demokratizimin e një-mendët.

Lulzim Peci

Instituti Kosovar për Kërkime Politike dhe Zhvillim (www.kipred.org) në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare Olof Palme (www.palmecenter.se) dhe Qendrën për Studime Aplikative për Negociata Ndërkombëtare (www.casin.ch) kanë punuar së bashku viteve të fundit në lëmin e aftësisë të kuadrove të institucioneve të Kosovës.

KIPRED dhe CASIN, të mbështetura nga Ministria e Punëve të Jashtme të Suedisë dhe OSBE-ja, në gusht të vitit të kaluar organizuan një seminar me temë: "Marrja e vendimeve në shtetin demokratik: sfidat në të ardhmen" për pesëmbëdhjetë anëtarët e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës. Negociati ishte tema specifike e cila u diskutua. KIPRED, e ka parë të udhës që të bëhen punë të mëtejshme në këtë lëmi, në konsultim me përfaqësuesit kryesorë të grupeve parlamentare të Kosovës. Pikërisht për këtë, KIPRED dhe CASIN më 5 mars 2003 organizuan seminarin një ditor mbi "Përgatitjet për negociata", që kishte për qëllim përgatitjen e institucioneve të Kosovës për negociata.

Seminarin e udhëhoqi Dr. Jean Fraymond, Drejtor i CASIN. Në seminar morrën pjesë përfaqësuesit e zgjedhur nga Kryesia, Kuvendi, Qeveria

dhe KIPRED. Pjesëmarrës tjerë në këtë seminar ishin Ramush Tahiri (Kryekëshilltar politik i Kryetarit të Kuvendit), Hydayet Hyseni (Anëtarë i Kryesisë së Kuvendit), Mahmut Bakalli (AK), Fadil Kryeziu (AK), Enver Hasani (Profesor në Universitetin e Prishtinës), Teuta Hadri (AK), Lulzim Peci (Drejtor ekzekutiv i KCSF/KIPRED) dhe Leon Malazogu (Drejtor i programit të KIPRED-it).

Ky seminar u përqëndrua rreth hollësive të veçanta që përdoren për përgatitjen e negociatave. Në rendin e ditës ishin përfshirë temat siç janë: caktimi i objektivave, grumbullimi i të dhënave, krijimi i qëndrimeve rreth negociatave, strategjive të negociatave, ndarja e detyrave dhe organizimi i negociatave. Sidoqoftë, përpos kësaj seminari u përqëndrua edhe rreth shqyrtimit të përvajave të mëparshme të negociatave në nivelin e lartë, duke përfshirë shembujt e dialogut të Izraelit-Palestinës (Oslo), Qipros, Rambujes, Dejtonit dhe Marcoussis-it.

Në fund, KIPRED-i i falënderohet Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe Qendrës për Studime Aplikative për Negociata Ndërkombëtare për përkrahjen e vazhdueshme të tyre në konsolidimin e partive politike dhe institucioneve qeveritare në Kosovë.

NJË KUVENDI TË FORTË I DUHET NJË SHËRBIM I FORTË CIVIL

Vetëm nëpunësit politikisht neutral mund të jenë garant se Kuvendi mund të funksionojë në përputhje me rregullat elementare demokratike. Por, çka ua mundëson nëpunësve civilë të veprojnë në mënyrë neutrale dhe të paanashme? Janë të drejtat dhe detyrat e tyre të përcaktuara me ligj si dhe kredibiliteti i institucioneve që i mbrojnë këto të drejta nga ndikimet politike dhe arbitrariteti.

Michael Georg Link, FNSt & Uli Steinle, FES

Dy fondacione gjermane, Friedrich-Naumann-Stiftung (FNSt.) dhe Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) i bashkuan forcat që nëpunësve civilë të Kuvendit t'u ofrojnë një seminar lidhur me mënyrën se si ata duhet ta mbrojnë dhe ta promovojnë kredibilitetin gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Më 26 mars 2003, rreth tetëdhjetë nëpunës të interesuar civilë u paraqitën në dhomën e konferencave për shtyp, për të marrë pjesë në këtë seminar.

Në sesionin e parë të trajnimit, Michael Georg Link nga FNS vuri në dukje se është me rëndësi që çdo institucion ta gjejë mënyrën e përshtatshme përmes së cilës nëpunësit civilë do të mund ta gjenin mënyrën adekuate për të krijuar një strategji të brendshme për vetëmbrojtje.

Ai bëri fjalë në përgjithësi mbi mënyrat e vetorganizimit të nëpunësve civilë në formë të një këshilli të punës, duke përmendur shembullin e "Personalrat"-it dhe të "Këshillit të Kuadrove" të Bundestag-ut gjerman. Në të vërtetë Këshilli i Kuadrove shërben si një organ i zgjedhur përfaqësues për mbrojtjen e interesave të nëpunësve të Parlamentit gjerman. Ky Këshill i Kuadrove merret me të gjitha çështjet madhore dhe minore të staftit dhe i shqyrton ato përmes diskutimeve të rregullta me Kryesinë e Parlamentit. Këto përfshihen çështje duke filluar nga rregulloret mbi orarin e punës, e deri te çështjet që kanë të bëjnë me hapësirën për parkimin e biçikletave, planifikimin e çerdhes së fëmijëve të parlamentarëve dhe vendosjen e bordeve të informacionit në të gjitha objektet e parlamentit. Këshilli i Kuadrove është shndërruar në një zëdhënës të besueshëm të interesave të staftit, duke u ndihmuar në këtë mënyrë anëtarëve të zakonshëm të staftit që të shprehen mirëfilli po edhe duke i ndihmuar jo vetëm Drejtoratit të Parlamentit, por edhe këtyre kuadrove, që t'i shfaqin mendimet e tyre, me rastin e jetësimit të kushteve të reja të punës. Në mënyrë që interesat e kuadrove të përfaqësohen në mënyrë optimale, Këshilli i kuadrove pranë Bundestag-ut gjerman duhet të zgjedhet rregullisht përmes votimit të fshehtë, përfshirë këtu përfaqësuesit e të gjitha niveleve. Pra, Këshilli i kuadrove, gjatë diskutimeve me Kryesinë e Parlamentit, përfaqëson tërë staftin.

Në sesionin e dytë, Uli Steinle (FES) foli për pozitën ligjore të nëpunësve civilë të Kosovës, konform me Rregulloren 2000/36 dhe me Direktivën Administrative 2003/2 të UNMIK-ut. Vëmendje e posaçme iu kushtua sqarimit të procedurave gjatë procedimeve të brendshme disiplinore si dhe të rasteve të ankesave dhe parashtresave mbi vendimet dhe sjelljet e menaxhmentit. Kjo kishte një rëndësi të veçantë meqë, jo vetëm anëtarët e bordit të brendshëm të sapoformuar disiplinor, por edhe ata të bordit të ankesave, ishin informuar si duhet mbi detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve.

Në diskutimin në vazhdim u vu në pah nevoja e vetorganizimit të nëpunësve civilë dhe e një njohje më të mirë të procedurave zyrtare gjatë aktiviteteve të

brendshme. U vu në dyshim mundësia që bordet e brendshme ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në mënyrë neutrale, meqë anëtarët e këtyre bordeve me gjasë janë emëruar, pra nuk janë zgjedhur në mënyrë kolektive. Mungesa e një kornize të detajuar ligjore mbi themelimin e këshillit të staftit gjithashtu u konsiderua si problem që duhet të shqyrtohet sa më parë që të jetë e mundur. Përgjithësisht mendohet se institucionet e brendshme edhe më tutje duhet ta vënë në pah efektshmërinë e tyre, posaçërisht për arsye se institucionet e jashtme, siç është Bordi i pavarur mbikëqyrës, ende nuk janë themeluar.

Dr. Friedhelm Frischenschlager, drejtor i Departamentit të Demokratizimit pranë OSBE-së, më pas prezantoi përfundimet e arritura gjatë seminarit të mbajtur për nëpunësit e lartë civil të Kuvendit. Ato ishin si vijon:

- Duhet të themelohet një këshill i kuadrove si mjet bashkëkohor i menaxhimit për t'u dhënë legjitimitet, qëndrueshmëri dhe racionalitet vendimeve të udhëqësive;
- Themelimi i këshillave të kuadrove është e drejtë themelore që mbrohet me shumicën e kushtetutave evropiane dhe me nenin 5 të Rregullores 2000/36 të UNMIK-ut;
- Ekziston nevoja për këmbimin e njohurive praktike me parlamentet tjera në mënyrë që të shtohet efektshmëria e shërbimit civil në Kosovë;
- Kuadrot e larta e mirëpritën këtë nismë dhe përkrahën krijimin gradual të praktikave të menaxhimit.

Sa i përket të ardhmes, të dy fondacionet gjermane do të vazhdojnë t'i përkrahin kuadrot e Kuvendit dhe ta ofrojnë ndihmën e tyre në procesin e themelimit të Këshillit të Kuadrove.



STAGNIMI POLITIK NË KOMUNA

Më 26 tetor të vitit të kaluar, votuesit shprehën vullnetin e tyre dhe dëshirën për një të ardhme më të mirë, duke shprehur se demokracia ishte mu aty pranë. Ky ishte vetëm një moment i cili i inkurajoi politikanët që t'i shërbejnë më mirë popullit. Në shumicën e komunave, faza e tranzicionit pas zgjedhjeve ishte e qetë dhe administratat e reja filluan punën e tyre. Megjithatë, kështu nuk ndodhi në çdo komunë. Disa qeveri lokale janë duke stagnuar.

Sven Lindholm

Në Kosovë po vërehet një stagnim politik, dhe një bojkotim i punës nëpër komuna. Pse ndodh kështu? Dhe çfarë janë qëllimet e pushtetit lokal nëse udhëheqësitë nuk i marrin përgjegjësitë në duart e tyre për t'i zgjidhur problemet?

"Këto stagnime politike ndodhin kryesisht për shkak se subjektet politike nuk e pranojnë humbjen," theksoi Ibrahim Makolli nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Anëtarët e zgjedhur të subjekteve politike dhe të personave që i kanë zgjedhur ata, kanë zgjedhur bojkotin si mjetin më të mirë për realizimin e interesave të tyre. Këto janë organet e njejta për të cilat njerëzit kanë votuar dhe të cilave ua kanë dhënë besimin.

Bojkotimi si mjet politik mund të përdoret në mënyrë efektive vetëm për të tërhequr vëmendjen rreth disa çështjeve të cilat nuk mund të zgjidhen brenda ditës. Madje, në raste të jashtëzakonshme të një stagnimi të këfillë, bojkotimi mund ta rrezikojë funksionimin normal të një institucioni. Për më tepër, bojkotimi mund të interpretohet edhe si mosnjohje dhe

refuzim i rezultateve të procesit demokratik.

"Bojkotimi pengon zgjidhjen e problemeve," shtoi Lutfi Haziri, Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Ai më tutje theksoi se, "bojkotimi pengon administrimin e drejtë dhe ofrimin e shërbimeve dhe njëkohësisht vështirëson bashkëpunimin...rreth shumë prioritetëve me intereset e përbashkët."

Bojkotimet në kuvendet komunale në Kaçanik dhe Novo Bërdë filluan vetëm atëherë kur roli udhëheqës i partive u zvogëluar seriozisht apo kur ato kaluan në opozitë. Këto bojkotime janë ende aktuale. Kështu, stagnimet në komunat tjera siç janë - Deçani, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Suhareka dhe Vitia - janë tregues të bojkotimit ose të protestave politike, që bëhen përmes mospjesëmarrjes së anëtarëve në Kuvend ose edhe në punën e komisioneve.

Në Lipjan, ku LDK-ja e humbi rolin e vet udhëheqës dhe ku PDK-ja fitoi më shumë vota, votuesit nuk i dhanë ndonjë mandat dhe përkrahje të qartë asnjë partie politike. Prandaj, ende

nuk është formuar as pushteti, dhe në këtë mënyrë është bllokuar edhe puna dhe aktivitetet e administratës komunale në të gjitha nivelet, madje edhe puna rreth miratimit të buxhetit për vitin 2003. Mirëpo, si duket Komisioni për Politikë dhe Financa ia ka dalur mbanë deri diku ta luajë rolin e Kuvendit Komunal, duke miratuar buxhete emergjente për të mbuluar nevojat elementare të disa departamenteve të komunës.

Z. Haziri, i cili poashtu është kryetar i Komunës së Gjilanit, shpreh bindjen se pjesëmarrja aktive mund të shpie drejt zgjidhjes së problemeve. "Është me rëndësi që të gjendet një kompromis i pranueshëm. Këto mosmarrëveshje të vogla të cilat po e pengojnë normalizimin e punës mund të tejkalohen vetëm përmes pjesëmarrjes më aktive", thekson Haziri.

Së këndejmi, edhe atëherë kur bojkotimi bëhet për shkaqe të arsyeshme, ai është gjithnjë negativ, ngase shkakton ngecje dhe nuk i kontribuon debatit. Ky refuzim mund të tregohet i suksesshëm vetëm kur është fjala për arritjen e

koncesioneve nga partitë tjera por, nuk duhet harruar se një veprim i këfillë do të ketë edhe pasojat. Është e vërtetë se puna mund të kryhet edhe pa pjesëmarrjen dhe ndihmën e bojkotuesve mirëpo, kjo punë do të tregonte rezultate shumë më të mira dhe më evidente, nëse ata do të merrnin pjesë në debat për të dhënë kontributin e tyre.

Në komunat e Vitisë dhe Suharekës ku LDK e ka shumicën, PDK-ja është duke i tërhequr anëtarët e vet në shenjë proteste ngase sipas z. Makolli, " shumica në Kuvend nuk i merr parasysh sugjerimet, vërejtjet apo propozimet e opozitës."

Anëtarët e PDK-së dhe AAK-së në Kamenicë janë duke e bojkotuar punën e Kuvendit dhe të komisioneve për shkak të qëndrimit që mban LDK-ja. Si rrjedhojë buxheti i komunës nuk shfrytëzohet sa duhet. Ndonëse, në mbledhjen e fundit të Kuvendit, është arritur një kuorum i ngushtë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve serb, që bëri të mundur miratimin e propozimeve.

Një çështje tjetër kontestuese është edhe pakënaqësia

lidhur me procesin e zgjedhjes së punëtorëve të shërbimit civil komunal. Fakti që shërbimi civil është parashikuar të jetë profesional dhe apolitik duket të jetë i parëndësishëm për partitë politike, ngase ato nuk heqin dorë dot nga përqaqjet e tyre për të siguruar pozita për "njerëzit e tyre".

Megjithatë, kjo situatë nuk është e pashpresë dhe mund të tejkalohet. Kështu, në të dy komunat në Rahovec dhe Shtime, ditët e fundit partitë politike arritën një marrëveshje e cila i dha fund stagnimit në këto komuna. Dhe meqë bojkotimi ende po vazhdon në Malishevë, PDK-ja, në shenjë kompromisi ndaj LDK-së, u pajtua me rritjen e numrit të vendeve në Komisionin për Politikë dhe Financa.

Shoqëria demokratike ka të bëjë shumë me debatin. Nuk ekzistonë asnjë problem që është zgjedhur pa bisedime. " Duke i shërbyer qytetarëve ne i shërbejmë Kosovës. Kjo mund të arrihet vetëm me pjesëmarrje aktive," përfundoi z. Haziri. Bojkotimi, refuzimi për të marrë pjesë, shpie vetëm drejt stagnimit dhe shkon në dëm të interesave dhe të zhvillimit të shoqërisë.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahen Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësisë në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përpunimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjyhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahen Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikant Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërpametar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Orari i aktiviteteve të ardhshme në mbështetje Kuvendit të Kosovës

Maj 2003

- 5 maj: seminar me juristët e Kuvendit të Kosovës, nga FNS-i.
- 9 maj: seminar mbi marrëdhëniet jashtëpartiake dhe brendapartiake, nga EWPPP.
- Ndërmjet 12 dhe 31 maj: Tryeza e rrumbullakët me Komisionin për Mirëqenie Sociale në lidhje me ligjin mbi skemën për ndihmë sociale dhe ligjin mbi marrëdhënien e punës dhe shëndetësinë, nga FES.
- Ndërmjet 12 dhe 31 majit: Tryeza e rrumbullakët me Komisionin e Shëndetësisë në lidhje me ligjin mbi prodhimet dhe pajisjet mjekësore, nga FES.
- Ndihma në themelimin e "këshillit të punës" për kuadrot e Kuvendit, nga FES.
- Ndihma në procesin e ligjvënjes, nga Bearing Point/ Barents.
- Këshilla, me kërkesën e grupit të ri parlamentar të "komuniteteve të tjera", nga OSBE-ja.
- Vizita zyrtare në Slloveni e Komisionit për barazi gjinore, nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri Civile (KCSF).
- Konsultat lidhur me ligjin mbi lirinë e informimit, nga NDI.
- Konsultat me deputetët e kuvendeve komunale dhe me ata të Kuvendit Qendror mbi marrëdhëniet me votuesit, nga NDI.
- Konsultat lidhur me përpilimin e fjalorit të termave dhe shprehjeve parlamentare dhe juridike, nga Z/KM, OSBE-ja, NDI dhe Sekretariati i Kuvendit.
- Fillimi i implementimit të projektit SPEAK-nga UNDP dhe IPU. SPEAK = Support to Parliamentary Electronic Archives in Kosovo (Mbështetje për krijimin e dosjeve elektronike për Kuvendin e Kosovës).
- në fund të majit: Konsultat mbi Rregullat e Procedures, nga FSNT.
- Koordinimi i vazhdueshëm i përkrahjes së Kuvendit nga donatorët në kuadër të ASI-t, nga OSBE-ja.

Qershor 2003

- Më pjesën e dytë të muajit qershor, seminari me Komisionin për Buxhet dhe me Komisionin për barazi gjinore mbi: "Planifikimin e buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore", nga OSBE-ja.
- Ndihma procesit të ligjvënjes, nga Bearing Point/ Barents.
- Konsultat lidhur me përpilimin e fjalorit të shprehjeve parlamentare dhe juridike, nga Z/KM, OSBE-ja, NDI dhe Sekretariati i Kuvendit.
- Seminare lidhur me ligjin mbi lirinë e informimit, nga NDI.
- 28 qershor deri më 1 5 korrik, vizita në Gjermani e delegacionit të përbashkët të Kuvendit dhe Qeverisë në lidhje me çështjet e arsimit, nga Konrad Adenauer Stiftung.
- Përkrahja procesit të ligjvënjes, nga Bearing Point/ Barents.

Korrik 2003

- 2 korrik: Konsultat me Komisionin për Tregti dhe Industri dhe me Komisionin për Ekonomi dhe Financa, nga FNS.